



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 141

Tiranë – E hënë, 4 gusht 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 444, datë 31.7.2025	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i segmentit rrugor dalje Elbasan–Përrenjas–Qafëthanë (faza IV)”	19783
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 445, datë 31.7.2025	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për zbatimin e projektit të portit të ri tregtar të integruar të Durrësit në Porto-Romano”	19785
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 448, datë 31.7.2025	Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit.....	19794
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 449, datë 31.7.2025	Për miratimin e kushteve të negocimit të shoqërisë shtetërore “KAYO” sh.a. me shoqëri private, për prodhimin dhe tregtimin e armëve të kalibrave të vegjël, të mesëm dhe dronëve.....	19800
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 451, datë 31.7.2025	Për trajtimin financiar dhe ekonomik të punonjësve të Policisë së Shtetit, të caktuar në detyrë si oficerë ndërlidhës jashtë vendit.....	19801
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 452, datë 31.7.2025	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar.....	19804
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 462, datë 31.7.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar.....	19841
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 463, datë 31.7.2025	Për miratimin e skemës së veçantë të garancisë shtetërore të huas për garantimin e huamarrjes së subjekteve në sektorin e bujqësisë.....	19844

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 464, datë 31.7.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”.....	19853
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 31.7.2025	Për emërimin e tre anëtarëve të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në.....	19854
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 470, datë 31.7.2025	Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2025.....	19854
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 471, datë 31.7.2025	Për disa ndryshime në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar.....	19855
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 473, datë 31.7.2025	Për disa ndryshime në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar.....	19856
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 41, datë 24.6.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-3138 (393), datë 22.11.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	19856
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 147, datë 8.7.2025	Mbi kërkesën e “TAP AG” për përjashtimin nga zbatimi i standardit ISO 27001.....	19861
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 148, datë 8.7.2025	Mbi pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SunPro” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	19862
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 149, datë 8.7.2025	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	19864
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 150, datë 8.7.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. “Për miratimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.....	19866
Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë datë 24.7.2025	Me objekt fillimin e procedurës së falimentimit.....	19867
	Për shpalljen të zhdukur të shtetasit Përparim Dalla.....	19868

**VENDIM****Nr. 444, datë 31.7.2025****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “ZGJERIMI I SEGMENTIT
RRUGOR DALJE ELBASAN–PËRRENJAS–
QAFËTHANË (FAZA IV)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i segmentit rrugor dalje Elbasan–Përrenjas–Qafëthanë (faza IV)”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truell”, “ndërtesë”, “apartament”, bodrum” dhe “njësi”, me një vlerë të përgjithshme prej 377 526 994.3 (treqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër pikë tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 377 526 994.3 (treqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër pikë tre) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i

përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Në momentin e ekzekutimit të procedurave për likuidim për çdo pasuri, objekt shpronësimi, duhet të kërkohet dokumentacion pronësie, i rifreskuar për secilin pronar, të konfirmuar nga institucioni kompetent, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me qëllim verifikimin e kufizimeve përkatëse që mbartin kartelat e pasurive, në bazë të të cilave do të vlerësohet dhe do të bëhet procedura e ekzekutimit të këtij vendimi.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Librazhd, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Librazhd, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “ZGJERIMI I SEGMENTIT RRUGOR DALJE ELBASAN–PËRRENJAS–QAFËTHANË (FAZA IV)”

PRONARI				TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM									SHËNIME (Kufizime hipotekore barre mbi pasuritë etj.)	
Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale	Sip. e shpronësimit (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqe e shpronësimit objekt banimi (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqe e shpronësimit objekt social-ekonomik (m²)	Vlerësimi me preventiv punimesh	Totali		
1	Arben	Bajram	Muçaku	2446	8/308	truall	300	248	2898	718,704.0				575.5	19777030.60	20,495,734.6		
2	Luçiano	Asim	Skura	2446	8/341	truall	210	210	2898	608,580.0				680.0	29435229.90	30,043,809.9		
3	Luçiano	Asim		2446	8/341+1-2	apartament	226				308.1	57,764.00	17,797,088.4			17,797,088.4		
	Albana	Nevruz	Skura															
4	"Dario Group"			2446	500/3	ndërtesë	480							480.0	19123597.70	19,123,597.7		
5	"Dario Group"			2446	500/4	truall	3593	3593	2898	10,412,514.0				961.0	40311092.70	50,723,606.7	Në seksionin E të kartelës ka sekastro dhe barre hipotekore sipas dok. nr. 7680, 9113, 9797, 9911, 10096, 10178, 10450, 11289, 11752, 21146	
6	"Dario Group"			2446	499/17	truall+ndërtesë	2031	1276	2898	3,697,848.0				954.0	44908506.89	48,606,354.9		
7	Agim	Hasan	Alla	2446	499/2	truall	300	277	2898	802,746.0	89.70	57,764.00	5,181,430.8	144.0	3928538.07	9,912,714.9		
8	Kosta	Pandeli	Faqolli	2446	499/4	truall	150	150	2898	434,700.0	300	57,764.00	17,329,200.0			17,63,900.0		
9	Rexhep	Rahman	Llushi	1527	496/10	truall	234.1	234.1	260	60,866.0		57764	9,681,246.4	130.9	5354147.60	15,062,687.5		
	Ismeqe	Rahman	Llushi															
10	Adile	Nazif	Llushi	1527	496/11-N	ndërtesë	161.2							161.2	5172162.20	5,172,162.2		
11	Ferit	Rahman	Llushi	1527	496/14	truall+ndërtesë	216.1	216.1	260	56,186.0		57764	5,112,114.0	176.2	6146977.80	6,186,094.8		
	Kadife	Hasli	Llushi															
12	Ilir	Selaudin	Gota	2446	499/21	truall	164	164	2898	475,272.0				109.6	5308988.30	5,784,260.3		
13	Shpetim	Rifat	Agolli	1063	147/3	truall	123	108.8	221	24,044.8						24,044.8		
14	Shpetim	Rifat	Agolli	1063	147/4	truall	177	177	221	39,117.0						39,117.0		
15	Shpetim	Rifat	Agolli	1063	147/8	truall	131	123.5	221	27,293.5	167.6	57764	9,681,246.4	130.9	5354147.60	15,062,687.5		
	Violeta	Farver	Agolli															
16	Edhart	Rexhep	Kushia	1063	600/21-B	bodrum	88.5							88.5	4353151.23			
17	Edhart	Rexhep	Kushia	1063	600/21-N	ndërtesë	88.5							88.5	4353151.23			
18	Edhart	Rexhep	Kushia	1063	600/21+1-2	apartament	88.5				88.5	57764	5,112,114.0					
19	Hysen	Rexhep	Kushia	1063	600/20	truall	101.2	101.2	221	22,365.2				303.6	14923694.03	14,946,059.2		
20	Xhevnje	Rexhep	Zhami	1063	600/55	truall	505.3	298	221	65,858.0						65,858.0		
21	Xhevnje	Rexhep	Zhami	1063	600/55-N-1	njësi	88.9							88.9	4455746.23			
22	Xhevnje	Rexhep	Zhami	1063	600/55-N-2	njësi	319.3							319.3	16003596.9			
23	Xhevnje	Rexhep	Zhami	1063	600/55-N-3	njësi	310.3							310.3	15552509.06			
24	Xhevnje	Rexhep	Zhami	1063	600/55-N-3/1	njësi	19.5							19.5	977364.02			
25	Xhevnje	Rexhep	Zhami	1063	600/55-N-3/2	njësi	92							92.0	4611120.96			
26	Xhevnje	Rexhep	Zhami	1063	600/55-N-4	njësi	58							58.0	2907011.04			
27	Xhevnje	Rexhep	Zhami	1063	600/55-N+1-1	apartament	328.7				328.7	57764	18,987,026.8			18,987,026.8		
28	Ismet	Met	Alla	2446	499/8	truall	66.12	66.12	2898	191,615.8				132.24	4939356.90	5,130,972.7		
	Fete	Xhebdin	Alla															
Vlera totale																	377,526,994.3	

**VENDIM****Nr. 445, datë 31.7.2025**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “PËR ZBATIMIN E
PROJEKTIT TË PORTIT TË RI TREGTAR
TË INTEGRUAR TË DURRËSIT NË
PORTO-ROMANO”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për zbatimin e projektit të portit të ri tregtar të integruar të Durrësit në Porto-Romano”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Portual Durrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “pyll”, “arë”, “truall” dhe “ndërtësë”, me një vlerë të përgjithshme prej 815 696 300.40 (tetëqind e pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind pikë dyzet) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 815 696 300.40 (tetëqind e pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind pikë dyzet) lekësh, përballohet nga Autoriteti Portual Durrës.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Portual Durrës.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren Zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet

këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Autoritetit Portual Durrës.

8. Në momentin e ekzekutimit të procedurave për likuidim për çdo pasuri, objekt shpronësimi, që miratohen me anë të këtij vendimi, do të kërkohej dokumentacioni pronësie i rifreskuar për secilin pronar, të konfirmuar nga institucioni kompetent, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me qëllim verifikimin e kufizimeve përkatëse që mbartin kartelat e pasurive, në bazë të të cilave do të vlerësohet dhe do të bëhet procedura e ekzekutimit të këtij vendimi, si dhe në rast se prona është në proces gjyqësor, masa e shpërblimit ose e kompensimit do t'i vendoset në dispozicion personit që rezulton nga vendimi i formës së prerë të gjykatës.

9. Autoriteti Portual Durrës kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

10. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Portual Durrës.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës-Kavajë-Krujë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Autoritetit Portual Durrës për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë, në favor të Autoritetit Portual Durrës për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

13. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Portual Durrës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës-Kavajë-Krujë, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrotjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “PËR ZBATIMIN E PROJEKTTIT TË PORTIT TË RI TREGTAR TË INTEGRUAR TË DURRËSIT NË PORTO-ROMANO”

		PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM													SHËNIME (Kufizime hipotekore, barre mbi pasuritë etj.)	
NR.		Emri	Adresa	Mbiemri	Fshati ose Qyteti	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale (m²)	*Are* (m²)	*Triull* (m²)	*Ndërtesë* (m²)	Volumi	Faqe	*ARE*			*TRUALL*			NDËRTESË SOCIAL- EKONOMIKE		*PYLL*			VLERA TOTALE (leke)			
															Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Cmimi (leke/m²)	Vlera (leke)	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Cmimi (leke/m²)	Vlera (leke)	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Vlera sipas preventivit	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Cmimi (leke/m²)	Vlera (leke)	Y	Z		
1		LUMTURI FERIT BUJAR SINAN DRITOR MERITA FATMANE MURAT BASHKIM DRITA SKENDER NAZMIJE FARUJE ETLEVIA FLAMUR FRIDUS		GANAJ GANAJ GANAJ GANAJ SHALA KORRIKU PERKAJ PERKAJ BUKLI PERKAJ GRIPSHI GANAJ HOXHA GANAJ GANAJ	RINIA	3184	1/2	PYLL	4.137					9	178	4.137							4.137	182	752.934	752.934.00			
2		RESHAT AVDUULLA FERIDE SULTTANIE FARIE SHERIFE		META META KACIMOLCELCINA KARRECI META	DURRES	3184	2/3	TRUALL	5.785					8	135		5.785	416	2.406.560							2.406.560.00			
3		LUMTURI FERIT BUJAR SINAN DRITOR MERITA FATMANE MURAT BASHKIM DRITA SKENDER NAZMIJE FARUJE ETLEVIA FLAMUR FRIDUS		GANAJ GANAJ GANAJ GANAJ SHALA KORRIKU PERKAJ PERKAJ BUKLI PERKAJ GRIPSHI GANAJ HOXHA GANAJ GANAJ	RINIA	3184	2/6	ARE	10.685					9	175	10.635	554	5.891.790								5.891.790.00			
4		LUMTURI FERIT BUJAR SINAN DRITOR MERITA FATMANE MURAT BASHKIM DRITA SKENDER NAZMIJE FARUJE ETLEVIA FLAMUR FRIDUS		GANAJ GANAJ GANAJ GANAJ SHANA KORRIKU PERKAJ PERKAJ BUKLI PERKAJ GRIPSHI GANAJ HOXHA GANAJ GANAJ	RINIA	3184	3/20	ARE	15.012					9	181	15.012	554	8.316.648								8.316.648.00			
5		KOZMA		KAJANA	RINIA	3184	7/1	ARE	11.400					6	6	11.400	554	6.315.600								6.315.600.00			
6		RESHAT AVDUULLA FERIDE SULTTANIE FARIE SHERIFE		META META KACIMOLI CELCINA KARRECI META	RINIA	3184	8/20	TRUALL	5.675		5675		8	137			5.675	416	2.360.800							2.360.800.00			
7		ILIR	JORGJI	THANAS	RINIA	3184	13/3	ARE	1.880					8	66	1.753	554	971.162								971.162.00			
8		INDRIT	QEMAL	SKORA	RINIA	3184	13/4	ARE+TRUALL	12.750		500	200	8	67	12.250	554	6.786.500	500	416	208.000	200	5.866.651				12.861.151.00			
9		ARDJANA	QEMAL	ZENELI	RINIA	3184	13/5	ARE	7.150				8	218	7.150	554	3.961.100									3.961.100.00			
10		LULJETA		BERISHA	RINIA	3184	13/7	ARE	3.575				8	226	3.434	554	1.902.436									1.902.436.00			
11		BASHKIM		XHAFA	RINIA	3184	13/9	ARE	3.483				8	234	3.317	554	1.837.618									1.837.618.00			
12		ILIR	JORGJI	THANAS	RINIA	3184	14/16	ARE	1.120				8	47	1.120	554	620.480									620.480.00			
13		PERPARIM	MASAR	SKENDO	RINIA	3184	14/19	ARE	2.930				8	220	2.930	554	1.623.220									1.623.220.00			
14		LULJETA		BERISHA	RINIA	3184	14/21	ARE	3.525				8	229	3.525	554	1.952.850									1.952.850.00			
15		BASHKIM		XHAFA	RINIA	3184	14/25	ARE	3.517				8	236	3.257	554	1.804.378									1.804.378.00			
16		MUHAMET		BLAKA	RINIA	3184	15/13	ARE	4.000				7	155	3.732	554	2.067.528									2.067.528.00			
17		HASAN		NEZAJ	DURRES	3184	15/17	ARE	1.000				7	159	975	554	540.150									540.150.00			
18		ADRIAN		LLANA	RINIA	3184	15/44	ARE	1.000				7	137	1.000	554	554.000									554.000.00			
19		ADEM	SKENDER	MIFTARI	RINIA	3184	15/71	ARE	5.000				7	117	5.000	554	2.770.000									2.770.000.00			
20		AFERDITA	XHELADIN	EREQI	RINIA	3184	15/95	ARE	10.000				8	44	10.000	554	5.540.000									5.540.000.00			
21		XHANE		KASMA	RINIA	3184	15/109	ARE	800				11	55	721	554	399.434									399.434.00			

Page | 19787

[illegible]

[illegible]

Page | 19789

106	LUAN		BRAHA	SPTALLE	8517	41/7	ARE	1,820				13	153	1,820	356	647,920												647,920.00	
106	SOKOL	DIN	BRAHA	SPTALLE	8517	41/8	ARE	2,600				13	154	2,466	356	877,896												877,896.00	
107	HAVE	REXHEP	BRAHA	SPTALLE	8517	41/9	ARE	1,950				13	155	1,950	356	694,200												694,200.00	
108	FADIL		BRAHAJ	SPTALLE	8517	41/10	ARE	4,550				13	156	3,623	356	1,289,788												1,289,788.00	
109	HAJK	MEM	BRAHA	SPTALLE	8517	41/11	ARE	10,400				13	157	9,540	356	3,396,240												3,396,240.00	
110	DRITAN		BRAHA	SPTALLE	8517	41/12	ARE	1,300				14	29	1,300	356	462,800												462,800.00	
111	ZARIFE	NEZR	BRAHA	SPTALLE	8517	41/13	ARE	5,200				13	159	5,200	356	1,851,200												1,851,200.00	
112	SHKURTE SYRIAN LULEZIME AVDYLLEREM ZEMRUE MMOZA	RASIM HASAN HASAN DURAKU BRAHAJ GASHI PEPOSHI	BRAHAJ	SPTALLE	8517	41/14	ARE	2,600				13	160	2,600	356	925,600												925,600.00	
113	ALI	DOGGAN	BRAHA	SPTALLE	8517	41/15	ARE	3,900				13	161	3,900	356	1,388,400												1,388,400.00	
114	ARBEN	ALI	BRAHA	SPTALLE	8517	41/16	ARE	1,300				13	162	1,300	356	462,800												462,800.00	
115	SUL		BRAHAJ	SPTALLE	8517	41/17	ARE	5,800				13	163	5,800	356	2,064,800												2,064,800.00	
116	ARBEN		DANI	SPTALLE	8517	41/18	ARE	14,550				13	164	14,550	356	5,179,800												5,179,800.00	
117	AHMET		BRAHAJ	SPTALLE	8517	42/1	ARE	5,200				13	206	5,200	356	1,851,200												1,851,200.00	
118	ZYLFE		BRAHAJ	SPTALLE	8517	42/2	ARE	6,500				13	207	6,500	356	2,314,000												2,314,000.00	
119	HAJON		BRAHAJ	SPTALLE	8517	42/3	ARE	13,000				13	208	13,000	356	4,628,000												4,628,000.00	
120	HALIT	ZYBER	BRAHA	SPTALLE	8517	42/4	ARE	6,500				13	209	6,500	356	2,314,000												2,314,000.00	
121	SABRI	ZYBER	BRAHA	SPTALLE	8517	42/5	ARE	5,200				13	210	5,200	356	1,851,200												1,851,200.00	
122	NEXHMUE		BRAHAJ	SPTALLE	8517	42/7	ARE	7,600				13	212	7,600	356	2,705,600												2,705,600.00	
123	GEZM		BRAHAJ	SPTALLE	8517	42/8	ARE	9,100				13	213	9,100	356	3,239,600												3,239,600.00	
124	REXHEP		BRAHAJ	SPTALLE	8517	42/9	ARE	7,600				13	214	6,710	356	2,388,760												2,388,760.00	
125	XHEVAHIRE		BRAHAJ	SPTALLE	8517	42/10	ARE	6,000				13	215	6,000	356</														

[illegible]

Page | 19791

186	SARA HALL	AGRON	AGALLIU GASHI	RNIA	3184	15106	ARE	16,000				10	217	15,493	554	8,583.122												8,583.122.00
189	SARA HALL	AGRON	HAXHI GASHI	RNIA	3184	15107	ARE	4,480				10	216	3,862	554	2,139.548												2,139.548.00
190	SARA HALL	AGRON	AGALLIU GASHI	RNIA	3184	15108	ARE	8,000				10	215	8,000	554	4,432.000												4,432.000.00
191	BAJRAM	SHYQRI	LIKMETA	RNIA	3184	1611	ARE	5,060				7	113	4,038	554	2,237.052												2,237.052.00
192	FETI	JUSUF	ISTREFI	RNIA	3184	1612	ARE	5,005				1	185	4,545	554	2,517.930												2,517.930.00
193	ARBEN		HAXHHYSENI	RNIA	3184	1613	ARE	11,876				1	188	11,876	554	6,579.304												6,579.304.00
194	ADEM	MUS	HOXHA	RNIA	3184	1614	ARE	11,997				3	2	11,942	554	6,626.948												6,626.948.00
195	MUSTAFA		GJKOLLI	RNIA	3184	1617	ARE	4,092				1	226	4,092	554	2,266.968												2,266.968.00
196	SHOO "STELLAR REAL ESTATE INVESTMENT ALBANIA" SHPK			RNIA	3184	1619	ARE	1,358				2	29	1,358	554	752.332												752.332.00
197	SHOO "STELLAR REAL ESTATE INVESTMENT ALBANIA" SHPK			RNIA	3184	16111	ARE	6,994				1	247	6,707	554	3,715.678												3,715.678.00
198	SHOO "STELLAR REAL ESTATE INVESTMENT ALBANIA" SHPK			RNIA	3184	16112	ARE	9,994				1	249	9,350	554	5,179.900												5,179.900.00
199	SHOO "STELLAR REAL ESTATE INVESTMENT ALBANIA" SHPK			RNIA	3184	16113	ARE	4,985				2	62	4,385	554	2,761.690												2,761.690.00
200	FERRACCO			RNIA	3184	16126	ARE	5,003				2	118	5,003	554	2,771.662												2,771.662.00
201	SELAMI	DAUT	SHETA	DR	3184	16127	ARE	5,000				2	119	4,812	554	2,665.848												2,665.848.00
202	MIRANDA KESJO INA		SHABA SHABA SHABA	RNIA	3184	16153	ARE	1,000				8	42	885	554	490.290												490.290.00
203	SHKELOQM		BESHIRI	RNIA	3184	16155	ARE	3,999				9	57	3,999	554	2,215.446												2,215.446.00
204	SHKELOQM		BESHIRI	RNIA	3184	16156	ARE	3,013				9	58	2,822	554	1,563.388												1,563.388.00
205	SHKELOQM		BESHIRI	RNIA	3184	16157	ARE	3,013				9	59	2,541	554	1,407.714												1,407.714.00
206	KURUM INTERNATIONAL SHA			RNIA	3184	16161	ARE	18,500				9	198	18,500	554	10,249.000												10,249.000.00
207	KURUM INTERNATIONAL SHA			RNIA	3184	16162	ARE	18,516				9	199	18,153	554	10,056.762												10,056.762.00
208	REXHEP		XHAKJA	RNIA	3184	16163	ARE	3,000				10	132	3,000	554	1,662.000												1,662.000.00
209	BESIM SHPRESA	HAMEZ -	BUÇPAPAJ BUÇPAPAJ	RNIA	3184	16164	ARE	4,957				10	133	4,592	554	2,543.968												2,543.968.00
210	MUSTAFA	GANI	ISTREFI	RNIA	3184	16166	ARE	7,850				12	217	6,512	554	3,607.648												3,607.648.00
211	NAZIF	IBRAHIM	HALLAQI	RNIA	3184	1711	ARE	3,594				4	34	3,594	554	1,991.076												1,991.076.00
212	DESTAN	IBRAHIM	HALLAQI	RNIA	3184	1712	ARE	5,396				4	32	5,364	554	2,971.656												2,971.656.00
213	BESIM	IDRIZ	HALLAQI	RNIA	3184	1714	ARE	600				4	30	600	554	332.400												332.400.00
214	HABIBE AZEM SADOK ISLAM MUSTAFA	SELIM GANI GANI GANI GANI	KOVAÇI KOVAÇI KOVAÇI KOVAÇI KOVAÇI	RNIA	3184	1715	ARE	2,300				4	36	2,300	554	1,274.200												1,274.200.00
215	SHAP		KOVAÇI	RNIA	3184	1716	ARE	2,184				4	38	2,178	554	1,206.612												1,206.612.00
216	FETAH	ELMAZ	HALLAQI	RNIA	3184	1717	ARE	5,706				3	241	5,637	554	3,122.898												3,122.898.00
217	HALIL	SELIM	DIDA	RNIA	3184	1719	ARE	1,001				3	223	995	554	551.230												551.230.00
218	XHEM		GJANA	RNIA	3184	17110	ARE	5,706				3	195	5,586	554	3,094.644												3,094.644.00
219	KUJTM	ALI	GJANA	RNIA	3184	17111	ARE	5,706				3	199	5,608	554	3,106.832												3,106.832.00
220	GFI ALBANIA			RNIA	3184	17122	ARE	5,182				3	226	5,182	554	2,870.828												2,870.828.00
221	ISMAL	GEZIM	MULLETI	RNIA	3184	17113	ARE	5,202				3	229	5,031	554	2,787.174												2,787.174.00
222	ISMAL	GEZIM	MULLETI	RNIA	3184	17114	ARE	5,205				3	233	5,051	554	2,798.254												2,798.254.00
223	ISMAL		MULLETI	RNIA	3184	17116	ARE	4,996				5	230	4,825	554	2,673.050												2,673.050.00
224	BEHAR		LLONA	RNIA	3184	17117	ARE	4,650				5	232	4,650	554	2,576.100												2,576.100.00
225	ALFRED	FEDMI	ONUZI	RNIA	3184	17121	ARE	7,511				3	191	7,268	554	4,026.472												4,026.472.00
226	DESTAN	HALIM	PECA	RNIA	3184	17122	ARE	3,607				3	199	3,604	554	1,996.616												1,996.616.00
227	LUTFI	DESTAN	PECA	RNIA	3184	17123	ARE	3,607				3	193	3,380	554	1,872.520												1,872.520.00
228	MEHMET	XHEM	MORINA	RNIA	3184	17124	ARE	3,607				3	185	3,588	554	1,987.752												1,987.752.00
229	SERVET	VATH	BALLA	RNIA	3184	17125	ARE	3,607				3	187	3,342	554	1,851.468												1,851.468.00
230	ZYMER	ASLLAN	MORINA	RNIA	3184	17126	ARE	7,030				4	7	6,891	554	3,817.614												3,817.614.00
231	ENGJELL		BASHKIM BURIMI	RNIA	3184	17130	ARE	1,000				7	227	946	554	524.084												524.084.00

[illegible]



276	SUGORE EMRANJA KASTRIOT ERNEST		NDOCI PJETRA NDOCI KOTICA NDOCI	RINJA	3184	2016	ARE	5.005				2	61	4.524	554	2.506.296											2.506.296.00	
277	MANUSHAQE		ORUÇI	RINJA	3184	2018	ARE	2.999				2	14	2.963	554	1.641.502											1.641.502.00	
278	NDOCI		VISHA	RINJA	3184	2011	ARE	5.005				2	17	4.898	554	2.691.332											2.691.332.00	
279	ARIFE		CALA	RINJA	3184	2012	ARE	3.993				2	18	3.892	554	2.156.168											2.156.168.00	
280	RAKIP		BOBCANI	RINJA	3184	2013	ARE	4.637				2	19	4.604	554	2.550.616											2.550.616.00	
281	RIDVANA	SAIT	DULAKU	RINJA	3184	2014	ARE	2.998				5	234	2.324	554	1.287.496											1.287.496.00	
282	RIDVANA		DULAKU	RINJA	3184	2015	ARE	1.000				5	233	1.000	554	554.000											554.000.00	
283	FRED		ÇELA	RINJA	3184	2016	ARE	1.000				5	231	1.000	554	554.000											554.000.00	
284	RIDVANA	SAIT	DULAKU	RINJA	3184	2017	ARE	1.000				5	227	997	554	562.338											562.338.00	
285	RIDVANA		DULAKU	RINJA	3184	2018	ARE	5.998				3	6	5.929	554	3.284.666											3.284.666.00	
286	MONDI		BARDHO	RINJA	3384	2024	ARE	1.000				9	80	949	554	525.746											525.746.00	
287	KAJTAS SHRIPESA	FEM	LIKAJ LIKAJ	RINJA	3184	2027	ARE	9.163				11	183	7.080	554	3.922.320											3.922.320.00	
288	ARDJAN		MUKA	RINJA	3184	2029	ARE	9.163				11	185	6.798	554	3.743.932											3.743.932.00	
289	MELEQE ILIR ARTUR ENVER ISTREF IRENA		VOJDULLA VOJDULLA VOJDULLA VOJDULLA VOJDULLA VOJDULLA	RINJA	3184	601	ARE	18.007				1	191	18.007	554	9.975.878											9.975.878.00	
290	FOJRETE MIRELA ERMAND BORJANA ELDA LIRKA ORJAKO ELJONA		SELMANI KASA SELMANI SELMANI SELMANI SELMANI SELMANI	RINJA	3184	611	ARE	30.000				1	186	30.000	554	16.620.000											16.620.000.00	
SHUMA TOTALE																								815.696.300.40				

Shënim: Me qëllim uljen e efekteve financiare me subjektet që kanë bërë kërkesë për shkëmbimin para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, negociohet brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.



VENDIM
Nr. 448, datë 31.7.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË
ZBATIMIT TË PUNIMEVE TË
NDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE
TË KANTIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Rregullat e detajuara për mënyrën e bashkëpunimit dhe detyrimet e zhvilluesit, drejtuesit teknik, zbatuesit të punimeve dhe mbikëqyrësit përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

3. Udhëzimi nr. 2, datë 13.5.2005, i Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen ministria përgjegjëse për zhvillimin e territorit, autoritetet përgjegjëse të inspektimit dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

RREGULLORE
E ZBATIMIT TË PUNIMEVE TË
NDËRTIMIT DHE RREGULLAT E
KANTIERIT

Neni 1
Objkti

Kjo rregullore përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e kantierëve të ndërtimit, pajisjen e tyre me mjetet e monitorimit elektronik si dhe përcakton detyrimet e zhvilluesit,

zbatuesit të punimeve, drejtuesit teknik dhe mbikëqyrësit, në kuadër të zbatimit të punimeve në përputhje me lejet e ndërtimit, sipas projektit të miratuar nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin e territorit.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, “Kantieri i ndërtimit” është hapësira fizike ku zhvillohen punimet ndërtimore, të miratuara me leje ndërtimi, dhe ku kryhen aktivitetet përgatitore, ndërtimore, teknike, logjistike dhe të sigurisë, të nevojshme për realizimin e projektit të miratuar.

Neni 3
Ngritja e kantierit dhe elementet dalluese

1. Për zbatimin e punimeve të ndërtim-montimit, në sheshin e liruar të ndërtimit ngrihet, përkohësisht, kantieri i punimeve, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në projektin e kantierit, të miratuar me lejen e ndërtimit.

2. Kantieri përfshin jo vetëm sipërfaqen e vetë objektit ndërtimor, por edhe zonat ndihmëse si:

- a) hapësirat për magazinim materiale;
- b) zonat për makineri dhe pajisje ndërtimi;
- c) rrugët e përkohshme të aksesit kur janë miratuar si të tilla me lejen e ndërtimit;
- ç) ambientet për punëtorët dhe stafin teknik;
- d) çdo strukturë tjetër të përkohshme që lidhet me zbatimin e projektit;

dh) plani i emergjencës për zjarrin, i vendosur në vende të dukshme, ku të përfshihen rrugët e evakuimit, vendndodhjet e pajisjeve kundër zjarrit (si fiksë zjarri portative, sisteme të përkohshme spinkleri, alarm i përkohshëm zjarri dhe detyrat e personelit të caktuara nga HSE-ja dhe eksperti zjarrfikës).

3. Kantieri i ndërtimit duhet të ngrihet duke respektuar rregullat, si më poshtë:

a) të jetë i rrethuar nga kamera sigurie, të paktën 4, nga një në çdo kënd të kantierit, ku të mund të sigurohet mbulim i plotë i territorit ku kryhen ndërtimet;

b) në çdo rast, në pamjet ballore të kantierit duhet të jenë të printuara imazhe të projektit të miratuar, ndërsa në pjesët anësore:



i. për kantieret brenda qyteteve, pamjet anësore duhet të përmbajnë të njëjtën ngjyrë si pamja ballore;

ii. për kantieret e ngritura në brezin bregdetar të pjesës jugore të Shqipërisë, pamjet anësore duhet të jenë vetëm me ngjyrë blu;

iii. për kantieret e ngritura në brezin bregdetar të pjesës veriore të Shqipërisë, pamjet anësore duhet të jenë vetëm me ngjyrë të gjelbër;

c) në rast se imazhet apo ngjyrat dëmtohen me kalimin e kohës, subjekti zhvillues ka detyrimin ta zëvendësojë dhe ta rinovojë rrethimin e kantierit, sipas rregullave të mësipërme, brenda 1 jave kalendarike;

ç) në vende të dukshme në kantier vendoset tabela e identifikimit të punimeve me të dhënat për objektin, destinacionin, lejen e ndërtimit, investitorin, subjektin projektues e mbikëqyrës dhe afatet e ndërtimit;

d) krahas tabelës identifikuese, vendoset edhe një tabelë ku listohen të gjitha miratimet përkatëse të lëshuara nga institucionet përgjegjëse.

4. Kantieri konsiderohet i ngritur në momentin që është vendosur rrethimi, sinjalistika, kamerat dhe tabelat informuese për objektin dhe subjektin ndërtues, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

5. Në kantierin e punimeve, tabela vendoset në një vend të dukshëm me një lartësi jo më pak se 4 metra nga niveli i rrugës (kur e lejon pozicioni urban) dhe në përmasa jo më të vogla se 1.3 metra gjerësi dhe 1.3 metra gjatësi, ku shkruhet në mënyrë të dukshme:

a) emërtimi i plotë i strukturës/objektit i cili do të zhvillohet;

b) leja e ndërtimit;

c) të dhëna teknike për projektin, shoqëruar me planimetrinë e vendosjes së strukturës në parcelë dhe pamjen 3 D të strukturës;

ç) sipërfaqja e ndërtimit;

d) intensiteti i ndërtimit;

dh) sipërfaqja e parcelës ose parcelave që preken nga zhvillimi;

e) numri i strukturave që krijohen nëse janë më shumë se një;

ë) sipërfaqja rrugore që ndërtohet;

f) numri i njësive të banimit nëse krijohen të tilla dhe sipërfaqja e përgjithshme e banimit;

g) numri i hapësirave të tjera nëse ka një tjetër funksion dhe sipërfaqja e përgjithshme për to;

gj) emri i personit fizik ose juridik projektues, duke përmendur edhe arkitektin edhe konstruktorin, emrin e inxhinierit mbikëqyrës, përgjegjësin e zbatimit të punimeve, së bashku me numrat përkatës të licencave;

h) një numër telefoni për kontaktim sipas nevojës;

i) afati i punimeve, data e fillimit dhe e mbarimit të punimeve në objekt;

j) të dhëna të tjera, që vlerësohen të nevojshme për të kuptuar projektin.

6. Në çdo rast, rrethimi i kantierit dhe tabela e kantierit nuk klasifikohet si tabelë, në kuptim të përcaktimeve të legjislacionit për sistemin e taksave vendore.

Neni 4

Detyrimi për vendosjen e kamerave

1. Kantieri duhet të jetë i rrethuar nga kamera, të paktën 4, nga një në çdo kënd të kantierit, ku të mund të sigurohet mbulim i plotë i territorit ku kryhen ndërtimet.

2. Zbatuesi i punimeve ka detyrimin të krijojë akses në çdo kohë mbi kamerat për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe për Agjencinë e Zhvillimit të Territorit (AZHT) për lejet e lëshuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit.

3. IKMT-ja dhe AZHT-ja mund të përdorin aksesin në kamerat e kantierëve të ndërtimit vetëm për qëllimin e verifikimit të zbatimit të projekteve të miratuara, në përputhje me lejet përkatëse të ndërtimit.

Neni 5

Mjetet e kantierit

1. Mbikëqyrësi ose zbatuesi i punimeve, brenda 15 ditëve nga ngritja e kantierit, ka detyrimin të njoftojë Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Agjencinë e Zhvillimit të Territorit për lejet e lëshuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, për listën e mjeteve të kantierit të pajisura me sistemin GPS funksional, të miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve.

2. Zbatuesi i punimeve ka detyrimin të krijojë akses në çdo kohë mbi sistemin GPS funksional të mjeteve të kantierit, të deklaruar sipas pikës 1, të këtij neni, për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe për Agjencinë e Zhvillimit të Territorit.



të Territorit (AZHT) për lejet e lëshuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit.

3. IKMT-ja dhe AZHT-ja mund të përdorin aksesin në GPS-në e mjeteve të deklaruara nga subjekti zhvillues vetëm për qëllimin e verifikimit të zbatimit të projekteve të miratuara në përputhje me lejet përkatëse të ndërtimit.

Neni 6

Kushtet dhe kriteret për subjektet zbatuese

1. Çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm për kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licencë.

2. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licencave profesionale, që miraton ministri përkatës për zhvillimin e territorit.

3. Drejtuesit ligjorë dhe teknikë të zbatuesit të punimeve janë përgjegjës përpara investitorit/zhvilluesit për ndërtimin e veprës, sipas lejes së ndërtimit dhe projektit të miratuar nga autoriteti kompetent, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi.

4. Edhe në rastet kur investitori ndërton për llogari të vet, ai duhet të jetë i pajisur me licencë për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

5. Ndarja e detyrave dhe e përgjegjësisë të zbatuesit të punimeve të kantierit, si dhe marrëdhëniet me investitorin, mbikëqyrësin lidhur me rregullat në kantier përcaktohen në rregulloren e brendshme, që hartohet nga sipërmarrësi i punimeve.

Neni 7

Detyrimet e zbatuesit të punimeve

1. Zbatuesi i punimeve të ndërtimit është çdo subjekt juridik, vendas ose i huaj, publik ose privat, i licencuar nga komisioni i dhënies së licencave pranë ministrisë përgjegjëse për zhvillimin e territorit, për të ushtruar veprimtari në zbatimin e punimeve të ndërtimit.

2. Zbatuesi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të

zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit, si dhe projektit të miratuar sipas lejes së ndërtimit, të miratuar nga organi përgjegjës i zhvillimit të territorit.

3. Investitori është i detyruar të lidhur kontratë noteriale për zbatimin dhe mbikëqyrjen e punimeve në kantier.

4. Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës në kushtet dhe afatet e përcaktuara, investitori i dorëzon zbatuesit të punimeve në origjinal:

a) dokumentacionin administrativo-ligjor për truallin dhe sheshin e ndërtimit;

b) lejen e ndërtimit;

c) projektin e zbatimit për punimet e ndërtimit, të infrastrukturës, montimit, sistemimit të territorit dhe preventivin e punimeve;

ç) planin e vendosjes (piketimit) të objektit;

d) përshkrimin teknik të punimeve dhe specifikimet teknike;

dh) lidhjen e veprës me infrastrukturën e zonës;

e) studimet inxhinierike, për ndërtimin e veprës (gjeologjik, sizmik, topografik, gjeoteknik, hidrologjik, hidraulik, të materialeve e produkteve të ndërtimit etj.).

5. Zbatuesi i punimeve ruan dhe nuk lejon përdorimin e kalimit të pronësisë së dokumenteve, që i vë në dispozicion investitori të personat e paautorizuar.

6. Sheshi i liru për ndërtim (për objektet e reja) ose mjediset, që do të rikonstruktohen, (për objektet ekzistuese) i dorëzohen zbatuesit nga zhvilluesi, me procesverbal, në tërësi ose pjesërisht, sipas kushteve të kontratës apo gjendjes faktike.

7. Zbatuesi i punimeve, prej fillimit deri në ditën e kolaudimit të punimeve, mbulon me shpenzimet e veta, korrigjon e zhdëmton çdo dëm që shkaktohet nga paaftësia, neglizhenca, të metat në zbatim, mungesa e masave mbrojtëse e sinjalizuese e përfaqësuesve dhe punonjësve në:

a) pronën e të tretëve dhe në mjedisin në afërsi;

b) rrjetin e infrastrukturës së zonës, në kantier e në afërsi;

c) punimet e ndërtimit, administrimin dhe përdorimin e makinerive, të pajisjeve, materialeve dhe produkteve në kantier.

8. Zbatuesi i punimeve, jo më pak se 10 ditë përpara fillimit të punimeve, njofton në sistemin e leje autoritetin që ka lëshuar lejen e ndërtimit, përkatësisht seksionin e urbanistikës pranë bashkisë apo sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të



Territorit dhe Ujit, sipas fushës së përgjegjësisë, dhe autoritetet përgjegjëse të inspektimit. Në njoftim jepen të dhëna për objektin, zhvilluesin, subjektin zbatues, subjektin projektues e mbikëqyrës, dokumentacionin administrativo-ligjor të miratuar dhe për personelin drejtues të kantierit të punimeve.

9. Zbatuesi i punimeve dhe drejtuesit teknikë janë përgjegjës, sipas përkatësisë, për tërësinë e masave organizative, teknike e teknologjike, ekonomike e financiare, higjienike e mjedisore për zbatimin e legjislacionit të punës e atë për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim, që garantojnë kryerjen e punimeve të ndërtimit në objekt dhe atyre ndihmëse në kantier, në kushte të sigurta për jetën e shëndetin e njerëzve dhe mbrojtjen e mjedisit.

10. Zbatuesi i punimeve është, në çdo rast, përgjegjës ndaj investitorit për punimet e nënsipërmarrjes dhe dokumentacionin teknik, ekonomik e administrativ.

11. Dokumentacioni fotografik apo videoregjistruesi sigurohet nga zbatuesi i punimeve për çastet më të rëndësishme të zbatimit të punimeve, veçanërisht për ato që bëhen të padukshme, që mund të jenë objekt diskutimi në të ardhmen dhe që pasqyrojnë masat mbrojtëse e të kontrollit të cilësisë së materialeve e të punimeve etj. Kopje të mjaftueshme i dorëzohen mbikëqyrësit, autoriteteve përgjegjëse të inspektimit dhe sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit për lejet e lëshuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, çdo gjashtë muaj, në sistemin e-leje.

12. Zbatuesi i punimeve detyrohet të sigurojë në kantier:

a) punëmarrës të aftë, të kontrolluar për shëndetin, me leje për ushtrim profesionale të veçanta (dëshmi, leje, autorizime) nga organet e autorizuar me ligj;

b) materiale, pajisje, mjete mbrojtëse, kolektive e individuale, dhe tabela paralajmëruese;

c) mbrojtjen e detyrueshme nëpërmjet vendosjes së skelave në strukturë, të daljeve të jashtme të objektit, si dhe mbrojtjen e mekanizmave e të pajisjeve nga goditjet e rrymave elektrike;

ç) mirëmbajtjen dhe kontrollin periodik të makinerive e të mekanizmave të instaluar në objekt për punë pa rrezik;

d) punonjës të kualifikuar dhe të autorizuar prej tij për instruktimin teknik dhe mbrojtjen në punë;

dh) rregullore, urdhra e udhëzime në fuqi për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë;

e) librin e instruktimit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë të punëmarrësve.

ë) librin për trajnimin e punonjësve për mbrojtjen nga zjarri dhe raportin e stimulimit periodik të evakuimit të punonjësve, të nënshkruara nga një ekspert zjarrrfikës. Simulimi realizohet të paktën 1 herë në 6 muaj.

Neni 8

Drejtuesi teknik

1. Detyra e drejtuesit teknik të zbatuesit të punimeve është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër, publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës.

2. Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i zbatuesit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

3. Drejtuesi teknik, për fillimin e punimeve në kantier, merr në dorëzim:

a) dokumentacionin identifikues ligjor, teknik e fiskal, të zbatuesit të punimeve (vendime, licenca, certifikata, autorizime);

b) dokumentin e lejes së ndërtimit;

c) projektin e zbatimit, të nënshkruar nga subjekti projektues, shoqëruar me përshkrimet teknike;

ç) vëllimet e punimeve, në lloje dhe zëra;

d) kontratën e sipërmarrjes dhe specifikimet teknike;

dh) projektin e përditësuar të rrjetit nëntokësor të infrastrukturës, në territorin e kantierit;

e) pikat e autorizuar të lidhjes provizore të kantierit me infrastrukturën e zonës;

ë) planin e vendosjes së objektit dhe të sistemit të territorit;

f) studimet inxhinierike, që lidhen me zbatimin e punimeve;

g) planorganizimin e punimeve.

4. Drejtuesi teknik njofton menjëherë mbikëqyrësin e punimeve për pasaktësitë, mospërputhjet, mungesat e të dhënave në vizatimet, përshkrimet e specifikimet teknike, paraqet propozimet e veta dhe pret udhëzimet e tij. Mungesat, pasaktësitë a mospërputhjet nuk përbëjnë



shkak për zgjidhje arbitrare apo justifikim të defekteve në punime.

Neni 9

Materialet dhe produktet e ndërtimit

1. Materialet dhe produktet e ndërtimit me standarde të detyrueshme vendosen në vepër kur janë shoqëruar me certifikatë cilësie, me rezultatet e provave dhe të analizave, që vërtetojnë ose vlerësojnë përputhshmërinë e tyre me standardet, që referohen në përshkrimet dhe specifikimet teknike.

2. Materialet dhe produktet e ndërtimit, që përdoren në punimet e ndërtimit, duhet të jenë të reja, të papërdorura dhe pa defekte nga veprimet ose mosveprimet e zbatuesit të punimeve.

3. Kur kantieri prodhon vetë materiale e produkte ndërtimi, me standarde të detyrueshme, duhet të jetë i pajisur me leje nga organi i autorizuar.

4. Materialet dhe produktet e ndërtimit, që nuk pranohen nga mbikëqyrësi i punimeve, sepse nuk plotësojnë kërkesat e projektit dhe të kontratës, nuk vendosen në objekt.

Neni 10

Punimet me defekte

1. Punimet e ndërtimit, që kanë të bëjnë me sigurinë e jetës e të shëndetit të njerëzve dhe mbrojtjen e mjedisit, merren në dorëzim me kontroll të dokumentuar në faza të ndërmjetme, sipas rregullave që përcaktohen në kushtet teknike të zbatimit. Në planin e veprimit përcaktohen punimet, kontrolli i të cilave bëhet në prani të përfaqësuesve të investitorit dhe të subjektit projektues.

2. Mbikëqyrësi i punimeve njofton zbatuesin për defektet e vëna re dhe kohën e korrigjimit të tyre. Punimet me defekte nuk pranohen dhe nuk financohen deri në korrigjimin e tyre.

3. Punimet me defekte të pakorrigjuara, që nuk cenojnë sigurinë e veprës dhe pranohen nga zhvilluesi, financohen me çmime të reduktuara.

4. Sistemet e infrastrukturës (elektrike, ujë-gaz-ajërsjellës, kanalizim, sinjalizim, ngrohje-ventilim etj.), të izolimit (nga uji-nxehtësia-zëri), të transportit (ashensorë, transportatorë etj.), të mbrojtjes nga zjarri a çdo sistem tjetër i lidhur në mënyrë të qëndrueshme me punimet e ndërtimit, merren në

dorëzim pasi provohen pa ngarkesë dhe me ngarkesë, në përputhje me kushtet teknike në fuqi.

Neni 11

Drejtuesi teknik

1. Drejtuesi teknik i kantierit ka këto të drejta dhe detyra:

a) të instruktojë dhe të riinstruktojë të gjithë punonjësit, çdo fillim muaji, në përputhje me programin mujor të punës;

b) të instruktojë, veçanërisht, punonjësit e rinj, që fillojnë punë për herë të parë, skuadrat e individëve, që vijnë rishtazi në kantier, që fillojnë një proces të ri pune apo që vendosen në punime të veçanta me shkallë vështirësie;

c) të largojë menjëherë nga puna çdo punëmarrës, që nuk zbaton masat e sigurimit teknik e të mbrojtjes në punë, si dhe të pezullojë punën kur nuk garantohen masat mbrojtëse;

ç) të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe të mekanizmave nga manovratorë të paafët;

d) të hartojë aktin e marrjes në dorëzim të skelave të jashtme.

2. Drejtuesi teknik i kantierit merr në dorëzim, me procesverbal të rregullt nga subjekti projektues, hartat/relievat topografike, pikat e referimit topogjeodezik (reperët), që sigurojnë lidhjen e objektit me terrenin. Ato ruhen deri në përfundim të kolaudimit të punimeve.

3. Drejtuesi teknik i kantierit verifikon saktësinë e lidhjes së objektit me terrenin dhe të piketimit të tij. Ai është përgjegjës për zbatimin e përpiktë të projektit, sipas vizatimeve, përshkrimeve teknike e ndryshimeve të miratuara prej tyre, në përputhje me kërkesat e kushteve teknike të zbatimit në fuqi, me specifikimet teknike të kontratës dhe sipas radhës teknologjike të punimeve.

4. Drejtuesi teknik i kantierit, për materialet me standarde të detyrueshme, merr kampione dhe njihet me rezultatet e testimit të tyre. Kur rezultatet janë më të ulëta se kërkesat e projektit dhe se standardet, projektuesi dhe investitori njoftojnë menjëherë për vlerësimin e pasojave dhe korrigjimin e defekteve.



Neni 12

Njoftimi për fillimin e punimeve

1. Njoftimi për fillimin e punimeve kryhet *on-line* në sistemin e-leje pranë autoritetit vendor të zhvillimit të territorit, autoriteteve të inspektimit dhe sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, për lejet në kompetencë të KKTU-së.

2. Në njoftim jepen të dhëna për objektin, investitorin/zbatuesin e punimeve, subjektin projektues e mbikëqyrës, dokumentacionin administrativo-ligjor të miratuar dhe për personelin drejtues të kantierit të punimeve.

3. Subjekti së bashku me njoftimin depoziton:

a) lejen e ndërtimit dhe projektin e zbatimit të miratuar për ndërtime në zona me vlera të veçanta (muzeale, turistike, mjedisore), lejet dhe aktet miratuese nga organet e autorizuar nga ligji;

b) studimet inxhinierike për ndërtimin e objektit;

c) planin e vendosjes së objektit dhe të sistemit të territorit;

ç) lidhjen e objektit me infrastrukturën e zonës;

d) planin e ngritjes dhe të organizimit të kantierit.

4. Autoriteti, që ka lëshuar lejen e ndërtimit, përkatësisht seksioni i urbanistikës pranë bashkisë apo sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, njoftohet detyrimisht në sistemin e-leje nga sipërmarrësi për kontrollin e punimeve menjëherë me piketimin e objektit, me përfundimin e punimeve në kuotën +/-0,00 dhe në përfundim të karabinasë.

Neni 13

Aktet e kontrollit

1. Aktet e kontrollit për proceset e ndërtimit nga subjektet, persona fizikë dhe juridikë, të pajisur me licencë në fushën e mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit, mbahen sipas fazave të mëposhtme:

a) ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues;

b) piketimi i strukturës ose veprave të infrastrukturës;

c) përfundimi i themeleve dhe kuota 0;

ç) përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin;

d) përfundimet e instalimeve elektrike, të ngrohjes, të ftohjes, hidraulike dhe të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, të komunikimit elektronik, përfshirë pikën e aksesit në godina sipas përcaktimeve në vendimin nr. 189, datë 30.3.2022,

të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për infrastrukturën e brendshme për rrjetet e komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe administrimin e pikës së aksesit në godina”;

dh) përfundimi i fasadave, rifiniturave dhe sistemit të jashtëm në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë dhe vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturën publike ekzistuese.

2. Piketimi i strukturës sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, njoftohet nga zbatuesi i punimeve brenda 5 ditëve në sistemin *on-line* të lejeve, pranë autoriteteve të inspektimit dhe për Agjencinë e Zhvillimit të Territorit (AZHT), për lejet e lëshuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit.

3. Aktet e kontrollit të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, janë të detyrueshme të depozitohen *on-line* në sistemin e-leje pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe sekretariatit teknik të KKTU-së në rastet në kompetencë të KKTU-së, të shoqëruara me një deklaratë përgjegjësie, të plotësuar nga subjekti/personi fizik, juridik që i ka hartuar, për çdo fazë ndërtimi dhe organi përgjegjës për zhvillimin e territorit ka detyrimin të verifikojë punimet e zbatimit nëpërmjet kontrollit fizik të detyrueshëm në terren, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç” dhe “dh” të pikës 1, të këtij neni.

4. Aktet e kontrollit të miratuara/refuzuara nga organi përgjegjës, sipas çdo faze punimi zbatimi, në çdo rast duhet t'i njoftohen inspektoratit qendror përgjegjës për kontrollin e territorit (IKMT) dhe atij vendor, si dhe AZHT-së.

Neni 14

Dokumentacioni teknik i zbatimit të punimeve gjatë ndërtimit

1. Gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në kantier hartohet e grumbullohet dokumentacioni teknik, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve i cili përmban:

a) dokumentacionin topografik të faktit për vendosjen e objektit e të rrjeteve të infrastrukturës për lidhjen e themeleve e të bazamenteve me tabanin, për kontrollin në plan e lartësi të objektit, të strukturave mbajtëse etj.;

b) dokumentacionin teknik për kontrollin dhe marrjen në dorëzim të strukturave, proceseve të ndërmjetme e rrjeteve, përpara se ato të bëhen të



fshehta, të punimeve të montimit të strukturave, makinerive e pajisjeve teknologjike, provave pa ngarkesë, rezultateve dhe ndreqjes së të metave;

c) dokumentacionin e vlerësimit dhe të vërtetimit të konformitetit të materialeve dhe produkteve, që hyjnë në procesin e ndërtimit.

2. Punimet e zbatimit gjatë të gjitha fazave të ndërtimit të objektit pasqyrohen në librin e kantierit, që mbahet në formën e ditarit të objektit e të raportit të punimeve.

3. Dokumentacioni i mbajtur në kantierin e ndërtimit është i njëjtë me dokumentacionin e përcaktuar në nenin 41, të vendimit nr. 610, datë 22.9.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve.”

Neni 15

Dosja teknike e objektit

1. Në kantierin e punimeve krijohet e plotësohet gradualisht dosja teknike e objektit, ku, sipas problematikës, mbahen:

a) dokumentacioni administrativo-ligjor për sipërmarrësin, si person juridik, dhe sheshin e ndërtimit;

b) projekti i zbatimit, përditësimet e ndryshimet, të miratuara gjatë zbatimit të punimeve, përshkrimet dhe specifikimet teknike;

c) preventivi i punimeve, sipas llojeve e zërave në sasi të çmimit përkatës dhe ndryshimet e tij;

ç) studimet inxhinierike për ndërtimin e objektit dhe përditësimet gjatë zbatimit të punimeve;

d) dokumentacioni teknik për punimet topografike, për punimet që bëhen të maskuara, për punimet e proceset e ndërmjetme, që merren në dorëzim, për provat pa ngarkesë të sistemeve, për ndreqjet e të metave gjatë periudhës së garancisë së punimeve;

dh) certifikatat e cilësisë së materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre;

e) projektorganizimi i punimeve;

ë) kushtet e përgjithshme e të veçanta të kontratës së sipërmarrjes;

f) libri i kantierit, i sigurimit teknik e i mbrojtjes në punë dhe libri i masave;

g) registri i kontabilitetit;

gj) deklarata teknike e punimeve.

h) plani i emergjencës dhe mbrojtjes nga zjarri për kantierin.

2. Dosja teknike e objektit, pas kolaudimit të punimeve, i dorëzohet zbatuesit të punimeve dhe ruhet në arkivin teknik të tij.

3. Investitori dhe mbikëqyrësi i punimeve krijojnë dosjen teknike të përbashkët, e cila arkivohet pranë investitorit.

4. Dosja teknike e objektit është dokument i rëndësishëm së veçantë dhe ruhet sipas afateve të caktuara në legjislacionin në fuqi.

VENDIM

Nr. 449, datë 31.7.2025

PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE TË NEGOCIMIT TË SHOQËRISË SHTETËRORE “KAYO” SHA ME SHOQËRI PRIVATE, PËR PRODHIMIN DHE TREGTIMIN E ARMËVE TË KALIBRAVE TË VEGJËL, TË MESËM DHE DRONËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kushteve të negocimit të shoqërisë “KAYO” sh.a me shoqëri private, me qëllim krijimin e një shoqërie aksionare të përbashkët për prodhimin dhe tregtimin e armëve të kalibrave të vegjël, të mesëm dhe dronëve, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare dhe sipas kushteve të përcaktuara në këtë vendim.

2. Shoqëria “KAYO” sh.a., negocion dhe pranon një pjesëmarrje jo më të ulët se 20% të aksioneve në shoqërinë e përbashkët, që do të krijojë me shoqëri private.

3. Shoqëria “KAYO” sh.a. kontribuon në entitetin e ri tregtar me pasuri të paluajtshme, në masën jo më pak se 5000 m², që do t'i jepen në përdorim shoqërisë së përbashkët, në një nga format



e parashikuara nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, pa të drejtë tjetërsimi dhe pa të drejtë transferimi të pronës, e cila do të mbetet në çdo rrethanë pronë e shoqërisë shtetërore “KAYO”, sh.a.

4. Shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., gjatë procesit të negocimit, në çdo rast, siguron nga subjekti më të cilin negocion, minimalisht:

a) një vlerë investimi jo më të ulët se 50 (pesëdhjetë) milionë euro;

b) ofrimin e linjave teknologjike të prodhimit ose montimit të armëve të kalibrave të vegjël, të mesëm dhe dronëve, sipas nevojave operacionale të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe strukturave të tjera të sigurisë;

c) sigurimin e rrjetit të shpërndarjes së produkteve në rast eksporti.

5. Shoqëria “KAYO” sh.a. siguron nga pala tjetër gjatë negociatave, se, përpos parashikimeve të tjera, objekti i aktivitetit të shoqërisë tregtare, që do të krijohet, do të përmbajë prodhimin, montimin dhe tregtimin e armëve të kalibrave të vegjël dhe dronëve për Forcat e Armatosura dhe për përdorim nga strukturat e tjera të sigurisë.

6. Shoqëria “KAYO” sh.a. siguron nga pala tjetër gjatë negociatave, se administratori/ët e shoqërisë, që do të krijohet nga dy shoqëritë e sipërpërmendura, zgjidhet me dakordësinë e shoqërisë “KAYO” sh.a.

7. Shoqëria “KAYO” sh.a. siguron nga pala tjetër gjatë negociatave, se, minimalisht 40 % e Këshillit Drejtues ose Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, që do të krijohet, në rast se forma e shoqërisë parashikon këto organe drejtuese/mbikëqyrëse, do të emërohen nga shoqëria “KAYO” sh.a.

8. Statuti i shoqërisë, që do të krijohet, përmban dispozitat mbi të drejtën e vetos, që gëzon shoqëria “KAYO” sh.a., në bazë të pikës 9, të nenit 10, të ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”.

9. Siguria fizike e personelit dhe infrastrukturës sigurohet nga Forcat e Armatosura, sipas akteve nënligjore, të nxjerra nga autoritetet kompetente, sipas ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

10. Ngarkohet shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 451, datë 31.7.2025

**PËR TRAJTIMIN FINANCIAR DHE
EKONOMIK TË PUNONJËSVE TË
POLICISË SË SHTETIT, TË CAKTUAR
NË DETYRË SI OFICERË
NDËRLIDHËS JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 8, të nenit 130, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Brendshme, brenda fondeve buxhetore vjetore, të miratuara për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, përballon shpenzimet e oficerit ndërlidhës dhe familjarëve, që i shoqërojnë ata gjatë kohës që shërbejnë në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe në organizatat ndërkombëtare jashtë vendit.

2. Për efekt të këtij vendimi, familjarë të oficerit ndërlidhës janë bashkëshorti/ja, fëmijët nën moshën 18 vjeç, si dhe persona të tretë, në kujdestari që shoqërojnë oficerin ndërlidhës, që shërben në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe në organizatat ndërkombëtare jashtë vendit.

3. Trajtimi financiar i oficerëve ndërlidhës, gjatë kohës që shërbejnë në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe në organizatat ndërkombëtare jashtë vendit, përfshin, si më poshtë vijon:

a) shpenzimet publicitare në interes të Policisë së Shtetit;

b) udhëtimet dhe dietat jashtë vendit pritës, kur këto kryhen në interes të Policisë së Shtetit;

c) udhëtimet dhe dieta, brenda vendit pritës;

ç) shpenzimet për përmbushjen e detyrimeve protokollare për pritjen e partnerëve zyrtarë, ceremonitë zyrtare të karakterit policor dhe pritje të personelit policor të nivelit të lartë në vendin pritës;



d) shpenzimet për mbështetjen e veprimtarive, veçanërisht të rëndësishme, të studentëve të policisë shqiptare në vendet përkatëse;

dh) uniformën;

e) qiranë e apartamentit, mirëmbajtjen e tij dhe të ambienteve të përbashkëta për ngrohje, gaz, energji elektrike dhe ujë, pajisje shtëpiake;

ë) siguracion, mirëmbajtje, riparim defekti dhe shërbimi karrotrec, karburant, parkim, regjistrim dhe kontrollet periodike në vendin pritës të automjetit;

f) komisionet bankare;

g) internetin dhe telefoninë fikse e të lëvizshme;

gj) shpenzimet për zyrë, mobilie e pajisje zyre dhe kancelari;

h) transportin e oficerit ndërlidhës dhe familjarëve të tij nga Shqipëria në kohën e emërimit, si dhe shpenzimet e transportit nga vendi i emërimit për në Shqipëri, kur ata mbarojnë detyrën;

i) transportin e sendeve personale në momentin e emërimit dhe kthimit në atdhe. Transporti i sendeve dhe orendive personale bëhet me miratimin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, deri në masën 7,4 m³ për anëtar familjeje, pa kaluar limitin e 30 m³ për çdo familje. Prokurimi i fondeve për mbulimin e këtyre shpenzimeve i nënshtrohet legjislacionit në fuqi;

j) sigurimin e jetës së oficerit ndërlidhës, që shërben në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe në organizatat ndërkombëtare jashtë vendit dhe të familjarëve të tyre, në rastet kur vendi pritës konsiderohet vend me rrezikshmëri të lartë. Sigurimi i jetës do të paguhet për sa kohë vazhdon situata e rrezikshmërisë së lartë. Prokurimi i fondeve për mbulimin e këtyre shpenzimeve i nënshtrohet legjislacionit në fuqi. Rrezikshmëri e lartë, për efekt sigurimi, sipas këtij vendimi, konsiderohen situatat, kur:

i. në shtetin pritës shpallet gjendja e luftës ose e jashtëzakonshme;

ii. në shtetin pritës mbizotërojnë situata të përkeqësuar të sigurisë dhe të rendit publik, të cilat vlerësohen të rrezikshme për jetën;

k) sigurimin e shëndetit gjatë udhëtimit.

4. Trajtimi financiar i familjarëve të oficerit ndërlidhës gjatë kohës që shërbejnë në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe në organizatat ndërkombëtare jashtë vendit përfshin, si më poshtë vijon:

a) sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të bashkëshortit/es për periudhën që shoqëron oficerin ndërlidhës, që shërben në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe në organizatat ndërkombëtare jashtë vendit. Masa e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për bashkëshortin/en llogaritet, përkatësisht, si më poshtë vijon:

i. për bashkëshortin/en, i cili/e cila, ka qenë në marrëdhënie pune përpara emërimit të oficerit ndërlidhës jashtë vendit, e barasvlershme me masën që është paguar në momentin e shkëputjes së marrëdhënieve të punës;

ii. për bashkëshortin/en, i cili/e cila nuk ka qenë në marrëdhënie pune përpara emërimit të oficerit ndërlidhës jashtë vendit, në masën e pagës minimale të sigurueshme në Republikën e Shqipërisë;

b) në rast se bashkëshorti/ja punësohet me kohë të pjesshme në misionet diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë ose në organizatat ndërkombëtare të vendit pritës, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paguhet në masën që është paguar në momentin e shkëputjes së marrëdhënieve të punës ose në rastin kur nuk ka qenë në marrëdhënie punë para emërimit të oficerit ndërlidhës jashtë vendit, në masën e pagës minimale të sigurueshme në Republikën e Shqipërisë;

c) pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për bashkëshortët e oficerëve ndërlidhës i nënshtrohet rishikimit në të njëjtën formë, siç rishikohet pagesa e kontributit për sigurimet shoqërore e shëndetësore të detyrueshme në Republikën e Shqipërisë;

ç) në rast se bashkëshorti/ja që shoqëron oficerin ndërlidhës punësohet në shtetin pritës, oficeri ndërlidhës njofton titullarin për këtë punësim;

d) për shkollimin e fëmijëve të oficerit ndërlidhës pagesa kryhet pas paraqitjes së dokumentacionit, si më poshtë vijon:

i. vërtetim nga autoritetet e vendit pritës, që shkollat publike në këtë vend janë me pagesë;

ii. vërtetim të masës së pagesës mujore/vjetore që duhet të paguhet për shkollimin e fëmijës, të lëshuar nga institucioni arsimor publik i vendit pritës ku do të studiojë fëmija;

iii. për rastet kur në shtetin pritës, gjuha e shkollimit në shkollat publike nuk është anglishtja, frëngjishtja, italishtja, gjermanishtja, spanjishtja, shkollimi i fëmijës të oficerit ndërlidhës mund të bëhet në shkolla private të licencuara dhe me



miratimin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit mbulohet tarifa për shkollimin për çdo fëmijë deri në masën 2 500 (dy mijë e pesëqind) euro në vit;

iv. shpenzimet e pagesës së librave dhe transportit;

dh) trajtim financiar mujor i bashkëshortit/es që shoqëron oficerin ndërlidhës, që shërben në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe në organizatat ndërkombëtare jashtë vendit, është në vlerën 50 (pesëdhjetë) për qind të pagës së pozicionit të punës të gradës “Atashe” të vendit të emërimit të oficerit ndërlidhës. Pagesa e trajtimit financiar mujor fillon pas vërtetimit të shoqërimit në detyrë të oficerit ndërlidhës nga bashkëshorti/ja në vendin pritës. Ky trajtim i nënshtrohet ndalesave të tatimit mbi të ardhurat, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Shpërblimi derdhet në llogarinë e bashkëshortit/es në një nga bankat e vendit pritës, ku bashkëshorti/ja ka llogarinë personale. Trajtimi financiar mujor, sipas kësaj shkronje, nuk përfitohet ose ndërpritet, në rastet kur:

i. bashkëshorti/ja emërohet në një nga pozicionet e stafit teknik në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe organizatat ndërkombëtare jashtë vendit apo punësohet në një vend pune në vendin pritës. Për çdo rast tjetër punësimi me kohë të pjesshme vijon përfitimi i trajtimit financiar mujor, sipas kësaj shkronje;

ii. bashkëshorti/ja e oficerit ndërlidhës nuk e shoqëron atë në detyrë në vendin pritës;

iii. bashkëshorti/ja nuk shoqëron oficerin ndërlidhës për më shumë se tre muaj rresht në detyrë;

e) trajtim financiar mujor për çdo fëmijë nën moshën 18 vjeç, që jeton me oficerin ndërlidhës, që shërben në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe në organizatat ndërkombëtare jashtë vendit, është në vlerën 20 (njëzet) për qind të pagës së gradës “Atashe” të vendit të emërimit të oficerit ndërlidhës. Ky trajtim financiar i nënshtrohet ndalesave të tatimit mbi të ardhurat, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Pagesa në këtë rast derdhet në llogarinë ku derdhet trajtimi financiar i oficerit ndërlidhës. Kur fëmija mbush moshën 18 vjeç dhe vazhdon studimet shkollë/universitare, vlera e masës 20 (njëzet) për qind të pagës së gradës “Atashe” vijon të jepet deri në përfundim të studimeve të plota shkollë. Pas përfundimit të studimeve/shkollës, trajtimi financiar i fëmijës së oficerit ndërlidhës ndërpritet.

5. Për shpenzime, që janë të përshtatshme të kryhen në vendin pritës, oficeri ndërlidhës dërgon ofertat në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila përzgjedh dhe miraton ofertën më të përshtatshme, në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin e prokurimit publik, të ndryshuar.

6. Kur oficeri ndërlidhës dërgohet me shërbim jashtë shtetit pritës ose kur vjen në atdhe, ndërkohë që në shtetin, ku kryen detyrën, ka lënë bashkëshorten dhe fëmijët, merr 100 për qind të trajtimit financiar, të dhënë për përkujdesje ndaj familjes së tij.

7. Kur oficeri ndërlidhës shtrohet për kurim në institucionet shëndetësore të shtetit, ku kryen detyrën ose në ndonjë shtet tjetër, ai vazhdon ta përfitojë pagesën përkatëse dhe trajtimin financiar, të dhënë për përkujdesjen ndaj familjes së tij.

8. Oficeri ndërlidhës dhe pjesëtarët e familjes, në ngarkim të tij, kanë të drejtë, që me miratimin e eprorit direkt dhe sipas rregullave të Policisë së Shtetit, për raste urgjencash, të mjekohen në vendin, ku oficeri kryen detyrën, kur, për këtë rast, nuk është parashikuar sigurimi shëndetësor. Shpenzimet përballohen nga buxheti i policisë së shtetit, ndërsa për rastet e tjera përballohen nga vetë oficeri ndërlidhës.

9. Në rastet e paaftësisë së përkohshme në punë të oficerit ndërlidhës, pagesa e tij bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

10. Oficeri ndërlidhës gëzon të drejtën e pushimeve javore, të pushimeve në ditët e festave zyrtare dhe të pushimit vjetor të paguar, për kohën që është me detyrë jashtë shtetit, sipas dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ministria e Brendshme mbulon shpenzimet e udhëtimit një herë në vit për oficerin ndërlidhës dhe familjen e tij për kryerjen e lejes së zakonshme në atdhe.

11. Me miratimin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, vetëm në rast fatkeqësie (vdekja e prindërve, bashkëshortit/es, fëmijës, vëllait dhe motrës), oficerit ndërlidhës dhe familjarëve shoqëruar u paguhen nga shteti shpenzimet e udhëtimit për ardhjen në atdhe dhe kthimin në vendin e huaj.

12. Ministria e Brendshme, për oficerët ndërlidhës dhe familjarët që i shoqërojnë, përballon sigurimet shëndetësore, sipas legjislacionit të shtetit përkatës, ku ata kryejnë detyrën.

13. Oficeri ndërlidhës ka të drejtë të përfitojë shpenzime udhëtimi, akomodimi dhe dietë, në



valutë të huaj, sipas legjislacionit në fuqi, kur emërohet në detyrë, thirret në atdhe ose dërgohet me shërbim në një shtet tjetër, si dhe kur kthehet në atdhe, në përfundim të detyrës.

14. Në rast humbjeje të jetës së oficerit ndërlidhës apo të pjesëtarit të familjes që e shoqëron në detyrë, shpenzimet për transportin e trupit në atdhe, si dhe ato të ceremonisë mortore përballohen nga buxheti i Policisë së Shtetit.

15. Ministria e Brendshme, brenda fondeve buxhetore vjetore, të miratuara për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, përballon efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi.

16. Vendimi nr. 759, datë 8.7.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e shpenzimeve të punonjësve shqiptarë, që shërbejnë si oficerë kontakti pranë ministrive të brendshme të shteteve të ndryshme, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

17. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2026.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

VENDIM

Nr.452, datë 31.7.2025

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN
NR.1128, DATË 30.12.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E
SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË
KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN
PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE
SHFUQIZIMIN E MASAVE
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE,
TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr.72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në kreun I bëhet shtesa e mëposhtme:

a) Në pikën 13, pas fjalëve “... (CFSP) 2025/1255 ...” shtohen “... (CFSP) 2025/1397 ...”;

b) Në pikën 29, pas fjalëve “... sipas aneksit 29 ...” shtohen “... i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2025/1349 ...”;

c) Në pikën 33, pas fjalëve “... (CFSP) 2025/824 ...” shtohen “... (CFSP) 2025/1435 ...”;

ç) Në pikën 35, pas fjalëve “... (CFSP) 2024/3139 ...” shtohen “... (CFSP) 2025/1429, (CFPS) 2025/1439 ...”.

2. Në aneksin 13, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2025/1397, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në aneksin 29, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2025/1349, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Në aneksin 33, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2025/1435, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Në aneksin 35, bashkëlidhur vendimit, shtohen vendimet (CFSP) 2025/1429, (CFPS) 2025/1439, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr.72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku



VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2025/1397

i 15 korrikut 2025

që ndryshon Vendimin (CFSP) 2020/1999 mbi masat kufizuese kundër shkeljeve dhe abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti Nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Duke qënë se:

- (1) Më 7 dhjetor 2020, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2020/1999 ⁽¹⁾.
- (2) Më 8 dhjetor 2020, me anë të Deklaratës së Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë ("Përfaqësuesi i Lartë"), në emër të Bashkimit Evropian, në lidhje me Regjimin Global të Sanksioneve për të Drejtat e Njeriut të BE-së, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare të tij riafirmuan angazhimin e tyre të fortë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në të gjithë botën. Regjimi Global i Sanksioneve për të Drejtat e Njeriut i BE-së nënvizon vendosmërinë e Bashkimit për të rritur rolin e tij në adresimin e shkeljeve dhe abuzimeve serioze të të drejtave të njeriut në të gjithë botën. Realizimi i gëzimit efektiv të të drejtave të njeriut për çdo person është një qëllim strategjik i Bashkimit. Respekti për dinjitetin njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut është një vlerë themelore e Bashkimit dhe politikës së tij të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë.
- (3) Bashkimi është i shqetësuar për shtypjen transnacionale nga organet shtetërore iraniane përmes përdorimit të vazhdueshëm të agjentëve të ndërmjetësuar, në veçanti duke përfshirë kriminelë dhe rrjete të krimit të organizuar që synojnë disidentët dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut në të gjithë botën, përfshirë edhe në territorin e Bashkimit. Këta kriminelë dhe rrjete të krimit të organizuar kanë qenë përgjegjës për shkelje ose abuzime serioze të të drejtave të njeriut, të tilla si vrasje jashtëgjyqësore, të shpejta dhe arbitrare, si dhe zhdukje me forcë të personave kritikë ndaj veprimeve ose politikave të Republikës Islamike të Iranit, ose të personave që konsiderohen kundërshtarë të Republikës Islamike të Iranit.
- (4) Në këtë kontekst, tetë persona dhe një entitet duhet të shtohen në listën e personave fizikë dhe juridikë, entiteteve dhe organeve të përcaktuara në Shtojcën e Vendimit (CFSP) 2020/1999.
- (5) Prandaj, Vendimi (CFSP) 2020/1999 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Shtojca e Vendimit (CFSP) 2020/1999 ndryshohet në përputhje me Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bruksel, 15 korrik 2025.

Për Këshillin
Presidenti
K. KALLAS

⁽¹⁾ Vendimi i Këshillit (CFSP) 2020/1999 i 7 dhjetorit 2020 mbi masat kufizuese kundër shkeljeve dhe abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut (OJ L 410 I, 7.12.2020, f. 13, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2020/1999/oj>).



EN

OJ L, 15.7.2025

SHTOICË

Shtojca e Vendimit (CFSP) 2020/1999 ndryshohet si më poshtë:
(1) shënimet e mëposhtme shtohen në listën e personave fizikë dhe juridikë, entiteteve ose organeve nën titullin "A. Personat fizikë":

Enrat (Transliterimi në alfabetin latin)	Enrat	Informacion identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
126. Naji SHARIFI-ZINDASHTI i/e njohur ndryshe si: KENANI, Emrihan SERIFI-ZINDASTI, Naci SERIFI-ZINDASTI, Naci SHARIFI ZINDASHTI, Naji SHARIFI-ZINDASHTI, Naji	ناجي ابراهيم شريفى زنديشى (Drejshkrimi persian)	Data e lindjes: 31.5.1974 Vendi i lindjes: Zindasht ose Orumiyeh, Iran Kombësia: Iraniane Gjinia: Mashkull ID: 2753229112 Entiteti i lidhur: Rrjeti Zindashti	Naji Sharifi-Zindashti është një trafikant iranian i narkotikëve dhe shefi i krimtut të organizuar. Ai është udhëheqësi i Rrjetit Zindashti, një grup kriminal që ka kryer akte të shumta represioni transnacional, duke përfshirë vrasje jashtë Iranit. Ai është i lidhur me Ministrinë Iraniane të Inteligjencës dhe Sigurisë (MOIS), e cila është dega e qeverisë iraniane e ngarkuar, ndër të tjera, me vrasjen e personave kritikë ndaj veprimeve ose politikave të Republikës Islamike të Iranit, ose personave që konsiderohen ndryshe si kundërshtarë të Republikës Islamike të Iranit nga Republika Islamike e Iranit. Prandaj, Naji Sharifi-Zindashti është përgjegjës për shkelje ose abuzime të rënda të të drejtave të njërut jashtë Iranit, në veçanti ekzekutime dhe vrasje jashtëgjyqësore, të përmblledhura ose arbitrare dhe zhdukje me forcë të personave.	15.7.2025
127. Abdulvahap KOCAK i/e njohur ndryshe si: Abdolvahab KOCAK, Abdolvahab KUÇHAK		POB: Adıyaman, Turkiye Kombësia: Turke Gjinia: Mashkull ID: UI2429867	Abdolvahap Kocak është zyrtarisht kopshitari i Naji Zindashtit. Ai shërbeu gjithashtu si vrasës me pagësë, i cili është implikuar në vrasje të shumta të urdhëruara nga Naji Zindashti dhe të ekzekutuara nga Rrjeti Zindashti. Në veçanti, Abdolvahap Kocak vrau disidentin iranian Mas'ud Molavi Vardanjani, një krim për të cilin ai u dënua në Turqi. Prandaj, Abdolvahap Kocak është i lidhur me Naji Zindashtin dhe Rrjetin Zindashti, të cilët janë përgjegjës për shkelje ose abuzime të rënda të të drejtave të njërut, duke përfshirë vrasje jashtëgjyqësore, të shpejta ose arbitrare. Ai është gjithashtu përgjegjës për shkelje ose abuzime të rënda të të drejtave të njërut jashtë Iranit, në veçanti vrasje jashtëgjyqësore, të shpejta ose arbitrare.	15.7.2025



	Emrat (Transliterimi në alfabetin latin)	Emrat	Informacioni identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
128.	Ali ESFANJANI	علي اسفنجاني (Drejshkrimi persian)	Data e lindjes: 15.8.1985 Kombësia: Iraniane Gjinia: Meshkull ID: P30251288	Si pjesë e një kompleti nga Ministria Iraniane e Inteligjencës dhe Sigurisë (MOIS) dhe Rrjeti Zindashti, Ali Esfanjani u njohtëua me disidentin iranian Mas'ud Molavi Vardajani, i cili MOIS-i informoi rreth tij dhe e çoi atë në vendin ku u vra nga Abdulvahap Kocak. Si i tillë, Ali Esfanjani është i lidhur me Naji Zindashti dhe Rrjetin Zindashti, të cilat janë përgjegjëse për shkelje ose abuzime të rënda të të drejtave të njeriut duke përfshirë vrasje jashtëligjësore, të shpejta ose arbitrare. Ai është gjithashtu i përfshirë drejtpërdrejt në një vrasje jashtëligjësore, të shpejtë ose arbitrare duke ndihmuar, përgatitur ose lehtësuar atë vrasje.	15.7.2025
129.	Ali KOCAK		Vendi i lindjes: Adiyaman Kaltra, Turkiye Kombësia: Iraniane Gjinia: Meshkull ID: 20926131442	Ali Kocak është vëllai i Abdulvahap Kocak dhe një bashkëpunëtor i Rrjetit Zindashti. Ali Kocak kreu mbikëqyrje mbi pronarin e televizionit iranian Gem, Saad Karimian, para vrasjes së tij dhe dyshohet se është përgjegjës për vetë vrasjen. Prandaj, Ali Kocak është i përfshirë në shkelje ose abuzime serioze të të drejtave të njeriut duke ndihmuar, përgatitur dhe lehtësuar vrasjet jashtëligjësore, të shpejta ose arbitrare. Për më tepër, Ali Kocak është zyrtarisht shpallur i Naji Zindashtit. Prandaj, Ali Kocak është i lidhur me Naji Zindashtin dhe Rrjetin Zindashti, të cilat janë përgjegjëse për shkelje ose abuzime serioze të të drejtave të njeriut, duke përfshirë vrasjet jashtëligjësore, të shpejta ose arbitrare.	15.7.2025



EN

OJ L, 15.7.2025

Emrat (Transliterimi në alfabetin latin)	Emrat	Informacion identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
130. Ekrem Abdulkerym OZTUNÇ i/e njohur ndryshe si: Ekrem OZTUNÇ		Data e lindjes: 7.10.1984 Vendi i lindjes: Yuksekova, Turqi Kombësia: Turke Gjinia: Mashkull Adresa: Orumiyeh, Azerbajxhani Perëndimor, Iran ID: U01292672	Ekrem Oztunc është nip i Naji Zindashit dhe një bashkëpunëtor i ngushtë i Rrjetit Zindashii. Ai ka luajtur një rol kyç në transmetimin, përmes kanaleve të koduara, të urdhrave për të vrarë gjatë përpjekjeve për vrasje të Rrjetit. Si i tillë, Ekrem Oztunc është i lidhur me Naji Zindashin dhe Rrjetin Zindashii, si dhe përgjegjës për planifikimin, urdhërimin, ndihmën ose lehtësimin e ekzekutimeve dhe vrasjeve jashtëgjyqësore, të shpejta ose arbitrare dhe zhdukjen me forcë të personave, të cilat përbëjnë shkelje ose abuzime të rënda të drejtave të njeriut.	15.7.2025
131. Mohammed Reza ANSARI		Kombësia: Iraniane Gjinia: Mashkull	Mohammed Ansari është udhëheqësi i Njësisë 840 të Forcës Quds të Gardës Revolucionare Islamiqe (IRGC). Ai udhëroi vrasjen e gazetarëve kritikë ndaj regjimit iranien, përfshirë dy gazetarë të Iran International. Prandaj, Mohammed Ansari është përgjegjës për planifikimin, ndihmën, përgatitjen dhe lehtësimin e vrasjeve jashtëgjyqësore, të cilat përbëjnë shkelje ose abuzime të rënda të drejtave të njeriut.	15.7.2025



OJ L, 15.7.2025

EN

Emrat (Transliterimi në alfabetin latin)	Emrat	Informacion identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
132. Nihat Abdul Kadir ASAN i/e njohur ndryshe si: ASAN, Nihat ASAN, Nihat Abdulkadir EBRAHIMHARKIAN, Ramin KURD, Ibrahim ASHAN, Nihat BAHTIYAR		Data e lindjes: 1.10.1981 ose 11.11.1981 Vendi i lindjes: Van, Turkiye Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull ID: 2751062326 (Iran) Pasaporta: U13927927 (Turkiye)	Nihat Asan është një bashkëpunëtor i ngushtë i Rrjetit Zindashti, i cili ka luajtur një rol kyq në planifikimin logjistik për shumë nga përpjekjet për vrasje të rrjetit. Si i tillë, Asan është i lidhur me Naji Zindashti dhe Rrjetin Zindashti. Ai është gjithashtu përgjegjës për planifikimin, urdhërimin, ndihmën ose lehtësimin e elzekutimeve dhe vrasjeve jashtëgjyqësore, të shpejta ose arbitrare, të cilat përbëjnë shkelje ose abuzime të rënda të të drejtave të njeriut.	15.7.2025
133. Reza HAMIDRAVARI i/e njohur ndryshe si: Reza HAMIDI RAVARI	رضا حمیدی راورى (Drejshkrimi persian)	Data e lindjes: 31.10.1963 Kombësia: Iraniane Gjinia: Mashkull ID: V40150378	Reza Hamidravari është një oficer inteligjence që punon për Ministrinë Iraniane të Inteligjencës (MOIS). Ai mbikëqyr operacionet e Naji Zindashtit të drejtuara nga MOIS, duke përfshirë vrasjen e disidentëve dhe krutëve të regjimit iranian. Si i tillë, Reza Hamidravari është i lidhur me Naji Zindashtin dhe Rrjetin Zindashti, të cilët janë përgjegjës për shkelje ose abuzime të rënda të të drejtave të njeriut, duke përfshirë vrasje jashtëgjyqësore, të kryera në mënyrë të përmblodhur ose arbitrare.	15.7.2025

ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2025/1397/oj>



EN

OJ L, 15.7.2025

(2) shënim i nëposhtitëm shtohet në listën e personave, entiteteve dhe organeve fizike dhe juridike nën titullin "B. Personat, entitetet dhe organet juridike";

Emrat (Transliterimi në alfabetin latin)	Emrat	Informacioni identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
'37. Rrjeti Zindashti i/e njohur ndryshe si: Rrjeti kriminal i Zindashtit Organizata kriminale Zindashti		Data e regjistrimit: 18.8.1983 Vendi kryesor i aktiviteteve: Iran, Turqi, Evropë Personat e lidhur: Naji Ibrahim Sharifi-Zindashti, Reza Hamidravani, Nihat Abdul Kadir Asan, Ekrem Abdulkerym Oztunc, Ali Esfandjani, Ali Kocak, Abdulvahap Kocak Subjekte të tjera të lidhura: Ministria e Prandaj, Rrjeti Zindashti është përgjegjës për shkelje ose abuzime të rënda të të Inteligjencës dhe Sigurisë së Iranit dhejtave të njërut jashtë Iranit, në veçanti ekzekutime dhe vrasje (MOIS), Revolucionari Islamik Trupat e Gardës (IRGC)	Rrjeti Zindashti është një grup kriminal që ka kryer akte të shumta represioni transnacional, duke përfshirë vrasje jashtë Iranit. Rrjeti Zindashti drejtohet nga trafikanti iranian i narkotikëve Naji Sharifi- Zindashti dhe është i lidhur me Ministrinë Iraniane të Inteligjencës dhe Sigurisë (MOIS), e cila është dëgja e qeverisë iraniane e ngarkuar, ndër të tjera, me mënblimin, si dhe vrasjen e personave kritikë ndaj veprimeve ose Nihat Abdul Kadir Asan, Ekrem politikave të Republikës Islamike të Iranit, ose personave që konsiderohen Abdulkerym Oztunc, Ali Esfandjani, ndryshe kundërshtarë të Republikës Islamike të Iranit nga Republika Islamike e Iranit. Subjekte të tjera të lidhura: Ministria e Prandaj, Rrjeti Zindashti është përgjegjës për shkelje ose abuzime të rënda të të Inteligjencës dhe Sigurisë së Iranit dhejtave të njërut jashtë Iranit, në veçanti ekzekutime dhe vrasje (MOIS), Revolucionari Islamik Trupat e Gardës (IRGC)	15.7.2025'



2025/1397

15.7.2025

**COUNCIL DECISION (CFSP) 2025/1397
of 15 July 2025****amending Decision (CFSP) 2020/1999 concerning restrictive measures against serious human rights violations and abuses**

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 7 December 2020, the Council adopted Decision (CFSP) 2020/1999 ⁽¹⁾.
- (2) On 8 December 2020, by way of the Declaration by the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy (the 'High Representative'), on behalf of the European Union, regarding the EU Global Human Rights Sanctions Regime, the Union and its Member States reaffirmed their strong commitment to the promotion and protection of human rights around the world. The EU Global Human Rights Sanctions Regime underscores the Union's determination to enhance its role in addressing serious human rights violations and abuses worldwide. Realising the effective enjoyment of human rights for every person is a strategic goal of the Union. Respect for human dignity, freedom, democracy, equality, the rule of law and human rights is a fundamental value of the Union and its common foreign and security policy.
- (3) The Union is concerned about transnational repression by Iranian state bodies through the ongoing use of proxy agents, in particular involving criminals and organised crime networks targeting dissidents and human rights defenders across the world, including on Union territory. Those criminals and organised criminal networks have been responsible for serious human rights violations or abuses such as extrajudicial, summary and arbitrary killings as well as enforced disappearances of persons critical of the actions or policies of the Islamic Republic of Iran, or of persons deemed to be opponents of the Islamic Republic of Iran.
- (4) In that context, eight persons and one entity should be added to the list of natural and legal persons, entities and bodies set out in the Annex to Decision (CFSP) 2020/1999.
- (5) Decision (CFSP) 2020/1999 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The Annex to Decision (CFSP) 2020/1999 is amended in accordance with the Annex to this Decision.

*Article 2*This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

4.	Micanor ALTËS a.k.a. Monel Felix, Micanord; Mikano; Wa Mikano; King Micanor; Alfred Mones	Function: Wharf Jérémie gang leader Nationality: Haitian Gender: male Address: Neighbourhood of Wharf Jérémie, near La Saline, Port-au-Prince, Haiti	Micanor Altès is the leader of the Wharf Jérémie gang. Wharf Jérémie is a coastal neighbourhood in the La Saline area of Port-au-Prince. This zone has been under the control of the gang led by Micanor Altès for over a decade. Under his command, the gang is responsible for the massacre of 207 people between 6 and 11 December, 2024 in the Wharf Jérémie district. The massacre occurred after the death of Altès' new born son from an unknown illness. Convinced that elderly Voodoo practitioners in the area under his control had cast a spell on his child, the gang leader ordered the execution of all inhabitants over 60 practicing Voodoo, after kidnapping them. Micanor Altès is therefore responsible for actions that threaten peace, stability and security in Haiti, including engaging in criminal activities and violence involving armed groups and criminal networks.	15.7.2025
5.	Christ-Roi CHÉRY a.k.a. Kris-La; Krisla; Chrisla; Chrislat	Function: Ti Bwa gang leader (affiliated with Viv Ansaum/G9 Coalition of gangs) Nationality: Haitian Gender: male Address: Commune of Carrefour, Metropolitan region of Port-au-Prince, Haiti	Christ-Roi Chéry is the leader of the Ti Bwa gang, which is affiliated with the Viv Ansaum (also called G9) coalition of gangs in Haiti. Since February 2024, the Ti Bwa gang has controlled the commune of Carrefour. Under Christ-Roi Chéry's command, the Ti Bwa gang is engaged in violence and criminal activities in Haiti, including murder, robbery, rape, hijacking of goods and trucks, extortion, targeted assassinations and drugs trafficking. Christ-Roi Chéry is therefore responsible for actions that threaten peace, stability and security in Haiti, including engaging in criminal activities and violence involving armed groups and criminal networks that promote violence, including forcible recruitment of children by such groups and networks, kidnappings, homicides and sexual and gender-based violence.	15.7.2025



OJ L, 15.7.2025

EN

	Name	Identifying information	Statement of reasons	Date of listing
6.	Jeff LAROSE a.k.a. Jeff; Gwo Lwa; Taliban	Function: Canaan gang leader (affiliated with G-Pép and Viv Ansaam coalitions of gangs) Nationality: Haitian Gender: male Address: Canaan, Metropolitan region of Port-au-Prince, Haiti	Jeff Larose is the leader of the Canaan gang, which is affiliated with the G-Pép and Viv Ansaam coalitions of gangs in Haiti. The Canaan gang controls the localities of Canaan, Onaville, Jerusalem, Corail, Rosenberg, Lilavois, Bon Repos, all located in the metropolitan area of Port-au-Prince. The gang extended its control over its original territory and also operates in Mirebalais (Centre department). Under Jeff Larose's command, the Canaan gang is engaged in violence and criminal activities in Haiti, including kidnapping, land appropriation, rape, home burglary, hijacking of goods and vehicles, ransom, murder and drug trafficking. Jeff Larose is therefore responsible for actions that threaten peace, stability and security in Haiti, including engaging in criminal activities and violence involving armed groups and criminal networks that promote violence, including forcible recruitment of children by such groups and networks, kidnappings, homicides and sexual and gender-based violence.	15.7.2025

ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2025/1429/oj>

3/3

**VENDIMI ZBATUES I KËSHILLIT (CFSP) 2025/1349
i 8 korrikut 2025****për zbatimin e Vendimit (PPJS) 2015/740 mbi me masat kufizuese në lidhje me situatën në Sudanin e Jugut**

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 31(2) të tij,

Duke pasur parasysh Vendimin e Këshillit (CFSP) 2015/740 të 7 majit 2015 në lidhje me masat kufizuese në lidhje me situatën në Sudanin e Jugut dhe shfuqizimin e Vendimit 2014/449/PPJS ⁽¹⁾, dhe në veçanti nenin 9(2) të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Duke qënë se:

- (1) Më 7 maj 2015, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2015/740.
- (2) Në përputhje me nenin 12(2) të Vendimit (CFSP) 2015/740, Këshilli ka shqyrtuar listën e personave që i nënshtrohen masave kufizuese të përcaktuara në Shtojcën II të atij Vendimi.
- (3) Këshilli ka arritur në përfundimin se masat kufizuese kundër një personi të listuar në Shtojcën II të Vendimit (CFSP) 2015/740 duhet të ruhen dhe se regjistrimi për atë person duhet të përditësohet.
- (4) Prandaj, Vendimi (CFSP) 2015/740 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Shtojca II e Vendimit (CFSP) 2015/740 ndryshohet në përputhje me Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi ditën pas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bruksel, më 8 korrik 2025

*Për Këshillin**President*

S. LOSE

⁽¹⁾ OJ L 117, 8.5.2015, p. 52, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2015/740/oj>.



AL

OJ L, 9.7.2025

Shtojca

Në Shtojcën II të Vendimit (CFSP) 2015/740, hyrja nr. 1 zëvendësohet me sa vijon:

Emri	Informacion identifikues	Deklarata e Arsyeve	Data e listimit
1. Michael MAKUEI LUETH	Data e lindjes: 1947 Vendi i lindjes: Bor, South Sudan; Bor, Sudan Gjinia: Mashkull	Michael Makuei Lueth ka mbajtur pozicionin e Ministrit të Informacionit dhe Transmetimit që nga viti 2013 dhe vazhdon ta mbajë këtë pozicion në Qeverinë e Përkohshme të Rifreskuar të Unitetit Kombëtar në Sudanin e Jugut. Ai ishte gjithashtu zëdhënës publik i delegacionit qeveritar në bisedimet e paqes të Autoritetit Ndërqeveritar për Zhvillim nga viti 2014 deri në vitin 2015 dhe nga viti 2016 deri në vitin 2018. Michael Makuei Lueth ka penguar, në veçanti përmes deklaratave publike nxitëse, zbatimin e Marrëveshjes për Zgjidhjen e Konfliktit në Sudanin e Jugut (ARCSS) të gushtit 2015 (e zëvendësuar në shtator 2018 nga "ARCSS e Rifreskuar" (R-ARCSS)), punën e Komisionit të Përbashkët për Monitorimin dhe Vlerësimin e ARCSS-së (JMEC), i riemërtuar "JMEC i Reformuar" sipas R-ARCSS), krijimin e Institucioneve të Drejtësisë të përkohshme parashikuara në ARCSS (të përfshira gjithashtu në R-ARCSS), si dhe operacionet e Forcës Rajonale të Mbrojtjes të Kombeve të Bashkuara. Përveç kësaj, Michael Makuei Lueth është i përfshirë në kufizimin sistematik të hapësirës politike dhe demokratike dhe në shtypjen e medias, duke përfshirë kërcënime të rregullta kundër gazetarëve dhe mbështetjes së censurës së medias, gjë që pengon demokratizimin dhe paqen e qëndrueshme në Sudanin e Jugut. Që nga fillimi i viti 2025, Michael Makuei Lueth ka hedhur poshtë publikisht thirrjet për dialog, duke përdorur retorikë konfrontuese dhe nxitëse në një mjedis gjithnjë e më të tensionuar. Michael Makuei Lueth ka mbrojtur gjithashtu arrestimet kundër Zëvendësprezidentit të Parë Riek Machar dhe aleatëve të tij, duke penguar përpjekjet për të qetësuar situatën. Prandaj, Michael Makuei Lueth ka penguar procesin politik në Sudanin e Jugut dhe është përgjegjës për shkeljet të rënda të të drejtave të njeriut, në veçanti të lirisë së shprehjes.	3.2.2018



2025/1349

9.7.2025

COUNCIL IMPLEMENTING DECISION (CFSP) 2025/1349

of 8 July 2025

implementing Decision (CFSP) 2015/740 concerning restrictive measures in view of the situation in South Sudan

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 31(2) thereof,

Having regard to Council Decision (CFSP) 2015/740 of 7 May 2015 concerning restrictive measures in view of the situation in South Sudan and repealing Decision 2014/449/CFSP⁽¹⁾, and in particular Article 9(2) thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 7 May 2015, the Council adopted Decision (CFSP) 2015/740.
- (2) In accordance with Article 12(2) of Decision (CFSP) 2015/740, the Council has reviewed the list of persons subject to restrictive measures set out in Annex II to that Decision.
- (3) The Council has concluded that restrictive measures against one person listed in Annex II to Decision (CFSP) 2015/740 should be maintained and that the entry for that person should be updated.
- (4) Decision (CFSP) 2015/740 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

Annex II to Decision (CFSP) 2015/740 is amended in accordance with the Annex to this Decision.

*Article 2*This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 8 July 2025.

*For the Council**The President*

S. LOSE

⁽¹⁾ OJ L 117, 8.5.2015, p. 52, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2015/740/oj>.



EN

OJ L, 9.7.2025

ANNEX

In Annex II to Decision (CFSP) 2015/740, entry No 1 is replaced by the following:

Name	Identifying information	Statement of Reasons	Date of listing
1. Michael MAKUEI LUETH	DOB: 1947 POB: Bor, South Sudan; Bor, Sudan Gender: male	Michael Makuei Lueth has held the position of Minister for Information and Broadcasting since 2013 and continues to hold that position in the Revitalised Transitional Government of National Unity in South Sudan. He was also the public spokesman for the government delegation to the Intergovernmental Authority on Development peace talks from 2014 to 2015 and from 2016 to 2018. Michael Makuei Lueth has obstructed, in particular through inflammatory public statements, the implementation of the Agreement on the Resolution of the Conflict in South Sudan (ARCSS) of August 2015 (replaced in September 2018 by the "Revitalised ARCSS" (R-ARCSS)), the work of the ARCSS Joint Monitoring and Evaluation Commission (JMEC, renamed "Reconstituted JMEC" under R-ARCSS), the establishment of the ARCSS Transitional Justice Institutions (also provided for in R-ARCSS), and the operations of the United Nations' Regional Protection Force. In addition, Michael Makuei Lueth is involved in the systematic curtailment of political and democratic space and in the repression of media, including through regular threats against journalists and support to media censorship, which hinders democratisation and sustainable peace in South Sudan. Since the beginning of 2025, Michael Makuei Lueth has publicly dismissed calls for dialogue, using confrontational and inflammatory rhetoric in an increasingly tense environment. Michael Makuei Lueth has also defended the arrests against First Vice-President Riek Machar and his allies, hampering efforts to deescalate the situation. Therefore, Michael Makuei Lueth has been obstructing the political process in South Sudan and is responsible for serious violations of human rights, in particular freedom of expression.	3.2.2018 ⁸



VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2025/1439

i 15 korrikut 2025

që ndryshon Vendimin e Këshillit (CFSP) 2022/2319 mbi masat kufizuese në lidhje me
situatën në Haiti

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti Nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Duke qënë se:

- (1) Më 25 nëntor 2022, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2022/2319 ⁽¹⁾.
- (2) Më 28 korrik 2023, në dritën e përkeqësimit të mëtejshëm të situatës politike, ekonomike, humanitare dhe të sigurisë në Haiti, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2023/1574 ⁽²⁾, i cili ndryshoi Vendimin (CFSP) 2022/2319 dhe krijoi një kuadër të ri masash shtesë kufizuese.
- (3) Në bazë të një shqyrtimi të masave të përmendura në nenin 2a (1) dhe nenin 3a (1) dhe (2) të Vendimit (CFSP) 2022/2319, dhe duke pasur parasysh seriozitetin e situatës në Haiti, këto masa duhet të rinovohen deri më 29 korrik 2026.
- (4) Prandaj, Vendimi (PBBK) 2022/2319 duhet të ndryshohet në përputhje me këtë,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Në nenin 8(2) të Vendimit (CFSP) 2022/2319, data '29 korrik 2025' zëvendësohet me atë të '29 korrikut 2026'.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi ditën pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bruksel, më 15 korrik 2025.

*Për Këshillin**Presidenti*

K. KALLAS

(1) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2022/2319, datë 25 nëntor 2022, mbi masat kufizuese në lidhje me situatën në Haiti (OJ L 307, 28.11.2022, f. 135, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2022/2319/oj>).

(2) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2023/1574, datë 28 korrik 2023, për ndryshimin e Vendimit (PBBK) 2022/ mbi masat kufizuese në lidhje me situatën në Haiti (OJ L 192, 31.7.2023, f. 21, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2023/1574/oj>).



2025/1439

16.7.2025

COUNCIL DECISION (CFSP) 2025/1439
of 15 July 2025
amending Council Decision (CFSP) 2022/2319 concerning restrictive measures in view of the
situation in Haiti

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 25 November 2022, the Council adopted Decision (CFSP) 2022/2319 ⁽¹⁾.
- (2) On 28 July 2023, in light of the further deteriorating political, economic, humanitarian and security situation in Haiti, the Council adopted Decision (CFSP) 2023/1574 ⁽²⁾, which amended Decision (CFSP) 2022/2319 and established a new framework of additional restrictive measures.
- (3) On the basis of a review of the measures referred to in Article 2a(1) and Article 3a(1) and (2) of Decision (CFSP) 2022/2319, and in view of the gravity of the situation in Haiti, those measures should be renewed until 29 July 2026.
- (4) Decision (CFSP) 2022/2319 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

In Article 8(2) of Decision (CFSP) 2022/2319, the date '29 July 2025' is replaced by that of '29 July 2026'.

Article 2

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 15 July 2025.

For the Council

The President

K. KALLAS

⁽¹⁾ Council Decision (CFSP) 2022/2319 of 25 November 2022 concerning restrictive measures in view of the situation in Haiti (OJ L 307, 28.11.2022, p. 135, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2022/2319/oj>).

⁽²⁾ Council Decision (CFSP) 2023/1574 of 28 July 2023 amending Decision (CFSP) 2022/2319 concerning restrictive measures in view of the situation in Haiti (OJ L 192, 31.7.2023, p. 21, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2023/1574/oj>).



VENDIM
Nr.462, datë 31.7.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR.389, DATË 13.5.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS DHE TË
TARIFAVE TË SHËRBIMEVE
KADASTRALE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 63, të ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. Për rastet e regjistrimit në regjistrin kadastral të pasurive të paluajtshme të institucioneve shtetërore dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, që kanë në përgjegjësi administrimi/pronësi pasuri të paluajtshme, Agjencia Shtetërore e Kadastrës aplikon tarifë të reduktuar, në masën 100 (njëqind) lekë.”.

b) Pas shkronjës “ë”, të pikës 9, shtohen shkronjat “f”, “g”, “gj”, “h”, “i” dhe “j”, me këtë përmbajtje:

“f) Agjencia e Zhvillimit të Territorit”;

g) Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve;

gj) Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”;

h) Korporata e Investimeve Shqiptare dhe SPV-të e krijuara me kapital të Korporatës apo me kapital të përbashkët me kontributet e një partneri publik;

i) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe drejtoritë rajonale të ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel kombëtar;

j) Institucionet shtetërore dhe organet e vetëqeverisjes vendore që kanë në përgjegjësi administrimi/pronësi pasuri të paluajtshme.”.

c) Numërtimi i pikave 9.1 dhe 9.2 zëvendësohet me numërtimin 9/1 dhe 9/2;

ç) Pas pikës 9/1 shtohen pikat 9/1/a dhe 9/1/b, me këtë përmbajtje:

“9/1/a. Për Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, shërbimet kadastrale, për të cilat nuk parapaguhet, janë edhe ato me numrat rendorë 66 dhe 66/1, sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

9/1/b. Për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe drejtoritë rajonale të ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel kombëtar, shërbimet kadastrale, për të cilat nuk parapaguhet, janë edhe ato me numrat rendorë 22 dhe 23, sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

d) Pika 9.2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9/2. Ato duhet t'i shlyejnë drejtorisë vendore të ASHK-së çdo muaj shumën e tarifave të shërbimeve kadastrale të ofruara në favor të muajit paraardhës. Përgjashtimisht, institucionet e përcaktuara në shkronjën “j”, të pikës 9, të kreut I, të këtij vendimi, shlyejnë shumën e tarifave çdo 6 (gjashtë) muaj. Në rast mosshlyerjeje të detyrimit të plotë brenda dy javëve nga përfundimi i afatit, drejtoria vendore e ASHK-së ndërpret ofrimin e shërbimeve ndaj institucionit deri në pagimin e tij.”.

2. Në kreun II bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 11 shtohet pika 11/1, me këtë përmbajtje:

“11/1 Aktet e fitimit, njohjes apo ndryshimit të së drejtës së pronësisë, të parashikuara në nenin 24, të ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”, duhet të pasqyrohen në seksionin përkatës së kartelës së pasurisë (B1:Të dhënat e regjistrimit paraprak), nëpërmjet shërbimit sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Ky shërbim nuk i nënshtrohet tarifimit sipas dispozitave të këtij vendimi. Tarifa për këtë shërbim përfshihet në tarifën e regjistrimit përfundimtar të aktit.”.

b) Në pikën 12 bëhen këto ndryshime:

i. Fjalët “... administrata tatimore ...” zëvendësohen me “... njësitë tatimore të qeverisjes vendore ...”;

ii. Fjalët “... administratës tatimore ...” zëvendësohen me “... njësitë tatimore të qeverisjes vendore ...”.

3. Në aneksin 1, bashkëlidhur vendimit në fuqi, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:



a) Të dhënat mbi shërbimin nr.59 zëvendësohen me të dhënat e shërbimit nr.59, sipas tabelës në aneksin 1/2, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) Shtohet shërbimi me nr.67, sipas tabelës në aneksin 1/2, bashkëlidhur këtij vendimi;

c) Të dhënat e shërbimeve me nr.5, nr.6, nr.7, nr.8, nr.9, nr.10, nr.11, nr.13, nr.17, nr.17/1, nr.17/2, nr.19, nr.21, nr.23, nr.25, nr.26, nr.27, nr.32, nr.35, nr.42, nr.43, nr.48, nr.49, nr.51, nr.52, nr.53, nr.54, nr.60, nr.62 zëvendësohen me të dhënat sipas shërbimeve në tabelën e aneksit 1/4, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Pas aneksit 1, bashkëlidhur vendimit në fuqi, shtohet aneksi 2, sipas aneksit me të njëjtin numër, bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Institucionet publike dhe shoqëritë aksionare me kapital shtetëror në likuidim, me përjashtim të rasteve të regjistrimit të pasurive në regjistrin kadastral, për shërbimet e tjera kadastrale tarifohen sa 1/10 e vlerës së përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe është pjesë

përbërëse e tij. Ato detyrohen të parashikojnë në projektbuxhetin e tyre shpenzimet e nevojshme për shlyerjen e tarifave të shërbimeve kadastrale. Për shërbimet kadastrale që ofrohen në funksion të shpronësimeve për interes publik, organi qendror, vendor apo subjekti privat, përfitues i shpronësimit, detyrohet të parashikojë shumën e tarifave të shërbimeve kadastrale, si pjesë të shpenzimeve procedurale të tij. Këto tarifa do të jenë të aplikueshme për një periudhë njëvjeçare nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Pas kalimit të këtij afati, institucionet publike do të paguajnë tarifat standarde për shërbime kadastrale sipas këtij vendimi.

IV. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për Zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

LISTA E SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRES

ANEKSI 1/2

Nr.	Lloji i shërbimit	Tarifa (Lekë)	Aplikimi ose jo i kamatvonesës (10 % e tarifës/ditë vonesë, por jo më shumë se 300 000 lekë)
59	Kopje të vërtetuara të dokumentave tekniko-ligjor në të cilat bazohet regjistri i pasurive të paluajtshme (të një dokumenti specifik / reference regjistrimi)	1000 lekë-faqe/ 4000 lekë	JO
67	Lëshim vërtetimi që subjektet nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën në 5 vitet e fundit,	1000 lekë /drejtori; 3000 lekë /për të gjithë territorin	JO

LISTA E SHËRBIMEVE TË DEKLARIMEVE PARAPRAKE TË OFRUARA NGA AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ANEKSI 2

Nr.	Lloji i shërbimit	Tarifa (Lekë)	Aplikimi ose jo i kamatvonesës (10 % e tarifës/ditë vonesë, por jo më shumë se 300 000 lekë)
1.	Regjistrimi paraprak i akteve të fitimit /njohjes/ndryshimit të pronësisë në regjistrin kadastral	0 (Tarifa për këtë shërbim përfshihet në tarifën e regjistrimit përfundimtar të aktit)	-



ANEKSI 1/4			
LISTA E SHERBIMEVE TE OFRUARA NGA AGJENCIA SHTETERORE E KADASTRES			
Nr.	Lloji i shërbimit	Tarifa (Lekë)	Aplikimi, ose jo, i kamatëvonesës (10% e tarifës/ditë vonesë, por jo më shumë se 300 000 lekë)
5	Regjistrimi i kontratës së shitjes	5000	PO
6	Regjistrimi i kontratës së dhurimit	5000	PO
7	Regjistrim i kontratës së shkëmbimit	5000	PO
8	Regjistrimi i heqjes dorë nga pronësia	5000	PO
9	Regjistrim i aktit të trashëgimisë	2000	PO
10	Regjistrim i pjestimit të pasurisë së paluajtshme me vendim gjykate/ apo marrëveshje noteriale.	5000	PO
11	Regjistrimi i titujve "në përdorim"	5000	PO
13	Regjistrimi i kontratës së qerasë/nënqerasë	5000	PO
17	Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, për kredi me vlerë deri në 1.000.000 lekë	8000	PO
17/1	Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, për kredi me vlerë 1 000.000 - 10 000 000 lekë	17000	PO
17/2	Regjistrimi i kontratës së hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka apo institucion tjetër kredidhënës, për kredi me vlerë mbi 10 000 000 lekë	30000	PO
19	Regjistrim i kontratave të tjera të hipotekës	2000	PO
21	Regjistrim i hipotekës ligjore	2000	JO
23	Fshirje e hipotekës (kontraktore, gjyqësore, apo ligjore)	2000	JO
25	Regjistrimi i përkohshëm i karabinasë	8000	PO
26	Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja.	8000	PO
27	Regjistrimi i Aktit të Bashkëpronësisë për objektet në bashkëpronësi të detyrueshme	10000	PO
32	Regjistrimi i marrëveshjeve dhe akteve lidhur me kufijtë e pasurive të paluajtshme	3000	PO
35	Regjistrim i akteve noteriale që lidhen ndërmjet zhvilluesit të pronës dhe pronarëve të truallit apo me subjekte të treta	4000	PO
42	Saktësim i kufijve të pasurisë tokë	3000	JO
43	Saktësim i kufijve të pasurisë ndërtesë	3000	JO
48	Kalim i regjistrimit nga regjistrat hipotekore në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, para ose pas përfundimit të regjistrimit fillestar.	2000	JO
49	Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale	1500	JO
51	Lëshim kopje karte të pasurisë	1500	JO
52	Lëshim vërtetimesh (negativ/pozitiv)	500 leke drejtori	JO
53	Lëshim certifikate pronësie	3000	JO
54	Lëshim vërtetim pronësie	2000	JO
60	Konsultim i kartelës së pasurisë së paluajtshme	1000	JO
62	Verifikimi online i gjendjes juridike të pronësisë dhe të dhënave të tjera të pasurisë së paluajtshme	1000	JO



VENDIM

Nr. 463, datë 31.7.2025

**PËR MIRATIMIN E SKEMËS SË
VEÇANTË TË GARANCISË
SHTETËRORE TË HUAS PËR
GARANTIMIN E HUAMARRJES SË
SUBJEKTEVE NË SEKTORIN E
BUJQËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e skemës së veçantë të garancisë shtetërore të huas, në vlerën 3 000 000 000 (tre miliardë) lekë, për garantimin e huamarrjes së subjekteve në sektorin e bujqësisë.

2. Skema e veçantë e garancisë shtetërore të huas do të lëshohet në favor të bankave tregtare të nivelit të dytë, si më poshtë vijon:

- a) Banka *Raiffeisen* sh.a.;
- b) Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.;
- c) Banka Kombëtare Tregtare sh.a.;
- ç) Banka Tirana sh.a.;
- d) Banka *Intesa Sanpaolo Albania* sh.a.;
- dh) Banka *Procredit* sh.a.;
- e) Banka Amerikane e Investimeve sh.a.;
- ë) Banka e Parë e Investimeve Albania sh.a.;
- f) Banka *Credins* sh.a.;
- g) Banka *OTP Albania* sh.a.;
- gj) Banka Union sh.a.

3. Marrëveshja e garancisë do të jetë sipas kushteve dhe kriterëve të marrëveshjes tip, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Autorizohet ministri i Financave për nënshkrimin e marrëveshjes së garancisë me bankat tregtare të nivelit të dytë, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Agjencia për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyera dhe Agjencia

për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, për ndjekjen dhe administrimin e kësaj skeme garancie.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për ndjekjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Këshilli i Ministrave
Përfaqësuar nga
Ministria e
Financave

Banka Raiffeisen sh.a.
Banka e Bashkuar e Shqipërisë
sh.a.
Banka Kombëtare Tregtare
sh.a.
Banka Tirana sh.a.
Banka Intesa Sanpaolo
Albania sh.a.
Banka Procredit sh.a.
Banka Amerikane e
Investimeve sh.a.
Banka e Parë e Investimeve,
Albania sh.a.
Banka Credins sh.a.
Banka OTP Albania sh.a.
Banka Union sh.a.

MARRËVESHJE GARANCIE
PËR GARANTIMIN E HUAMARRJES SË
SUBJEKTEVE NË SEKTORIN E BUJQËSISË

MARRËVESHJE TIP
Deri në 3 miliardë lekë

Datë

Preambulë

Qëllimi i skemës së garancisë është që të stimulojë huadhënien nga bankat tregtare që operojnë në Republikën e Shqipërisë, për t'i mundësuar ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në sektorin e bujqësisë si dhe fermerëve të cilët janë të regjistruar dhe të pajisur me certifikatën e NIPT-it të fermerit, investime për asete fizike dhe teknologjike që rrisin kapacitetet prodhuese, cilësinë e prodhimit dhe eficiencën operacionale të tyre. Gjithashtu, kjo skemë garancie mbështetet në programin e miratuar në Marrëveshjen Kuadër, ndërmjet Bankës së Shqipërisë, përfaqësuar nga



zëvendësguvernatori i dytë dhe bankave, përfaqësuar nga drejtorët ekzekutivë, “Për pjesëmarrjen në Programin e Financimit të Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm në Shqipëri”, lidhur më 14.2.2025 në Tiranë.

Financimi parashikohet të mbështesë rritjen e prodhimit, si dhe agropërpunimit, nëpërmjet nxitjes së investimeve në drejtim të përmirësimit teknologjik me synim garantimin e vijueshmërisë në rritjen e eksporteve dhe përmirësimin e cilësisë.

Kjo marrëveshje garancie (“Marrëveshja e Garancisë”) e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (“MF”), dhe Bankave (“Huadhënësit”), bëhet për të përcaktuar kushtet e pjesëmarrjes së Huadhënësve në këtë skemë garancie të lëshuar nga Ministria e Financave si përfaqësuese e Këshillit të Ministrave, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, menaxhuar nga Agjencia e Menaxhimit të Garancive, Agjencia Kredive të Pakthyer (AMGKP) dhe Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR).

Marrëveshja e Garancisë nuk përbën detyrim të drejtpërdrejtë për shtetin (në këtë Marrëveshje përfaqësuar nga MF-ja), por përfaqëson një detyrim të mundshëm të tij. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtpërdrejtë në rastin kur përfutuesi i drejtpërdrejtë i huas (“Huamarrësi”) nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huan e garantuar (“Huaja”), në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huas (“Marrëveshja e Huas”) dhe janë plotësuar kushtet e parashikuara shprehimisht në këtë Marrëveshje.

Për sa më sipër, si edhe për të mundësuar realizimin e qëllimit të kësaj Marrëveshje, palët bien dakord me kushtet si më poshtë:

Neni 1 Baza ligjore

Kjo Marrëveshje Garancie është hartuar mbështetur në:

- Nenet 34–43 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

- Nenin 57 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

- Ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

- Ligjin nr. 55/2023, datë 29.12.2023, “Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyer”

- Ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar,

- Nenin 5 të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 11.6.2025, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 115/2024, ‘Për buxhetin e vitit 2025’”, i ndryshuar;

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 719, dt. 31.10.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”;

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. _____, datë _____ “Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve në sektorin e bujqësisë”

- Marrëveshja Kuadër ndërmjet Bankës së Shqipërisë, përfaqësuar nga zëvendësguvernatori i dytë dhe bankave, përfaqësuar nga drejtorët ekzekutivë “Për pjesëmarrjen në Programin e Financimit të Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm në Shqipëri”, lidhur më 14.2.2025 në Tiranë.

Neni 2 Garancia

1. MF-ja merr përsipër të garantojë Huadhënësit deri në vlerën 3 miliardë lekë (“vlera e garancisë”), sipas kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara shprehimisht në këtë Marrëveshje. Vlera e garancisë përfaqëson shumën maksimale të pagesave që do të kryhen nga MF-ja për të shlyer detyrimet e papaguara ndaj Huadhënësit që burojnë nga huat që do t’i nënshtrohen kësaj skeme garancie.

2. MF-ja merr përsipër të garantojë deri në vlerën e garancisë të cituar në pikën 1 të këtij neni, 70% të kryegjësë të çdo Huaje që Huadhënësit do t’u lëvrojnë Huamarrësve sipas kushteve që pasojnë në këtë Marrëveshje.

3. “Vlera e garantuar e Huas” do të jetë shuma maksimale e garantuar nëpërmjet kësaj Marrëveshje përkatësisht për secilën nga huat e lëvruara nga Huadhënësit, në zbatim të kushteve të kësaj Marrëveshje dhe e cila do të jetë e barabartë me prodhimin e kryegjësë të Huas me përqindjen e kryegjësë të garantuar nga MF-ja sipas pikës 2 të këtij neni.



4. Në asnjë rast, MF-ja nuk merr përsipër garantimin e interesave, kamatëvonesave, penaltiteteve apo çdo lloj detyrimi tjetër monetar, që mund të burojë nga huat që Huadhënësit do t'i lëvrojnë Huamarrësve.

5. Për qëllimin e mostejkalimit të vlerës së garancisë të cituar në pikën 1 të këtij neni, Huadhënësit do të raportojnë menjëherë pranë AMGKP-së me *e-mail* në adresat e përcaktuara në nenin 8 të kësaj Marrëveshje, për çdo aplikim të miratuar dhe shumën përkatëse. AMGKP-ja do t'i konfirmojë Huadhënësit përkatës nëse aplikimi i miratuar nga Huadhënësi nuk shkakton tejkalim të vlerës së garancisë, dhe vetëm pas marrjes së këtij konfirmimi, Huadhënësi mund të procedojë me lidhjen e kontratës përkatëse të kredisë, dhe njofton menjëherë AMGKP-ja për nënshkrimin e kontratës së kredisë.

Neni 3

Kriteret e kualifikimit të Huamarrësve dhe kriteret për përfitimin e Huas

1. Huadhënësit do të japin Hua të garantuar sipas kësaj Marrëveshje subjekteve mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe fermerëve të cilët janë të regjistruar dhe të pajisur me certifikatën e NIPT-it të fermerit, sipas tipit të investimit në përputhje me prioritetet e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, sipas aneksit 2.

2. Subjektet do të dorëzojnë pranë Huadhënësve:

- a) formularin e aplikimit;
- b) projektpropozimin;
- c) subjektet juridike duhet të dorëzojnë, ekstrakt të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit, ndërsa fermerët duhet të dorëzojnë, certifikatë regjistrimi, vërtetim për llojin e aktivitetit bujqësor.

3. Huamarrësit duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

a) Huamarrësi duhet të jetë subjekt i cili zhvillon aktivitetin si ndërmarrje mikro, e vogël dhe e mesme apo fermer i regjistruar dhe i pajisur me certifikatën e NIPT-it të fermerit në sektorin e bujqësisë;

b) Huamarrësi duhet të jetë subjekt i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit", dhe struktura e kapitalit të zotërohet 100% nga subjekte

jopublike, si dhe fermerët të cilët janë të regjistruar dhe të pajisur me certifikatën e NIPT-it të fermerit;

c) Huamarrësi nuk duhet të ketë detyrime tatimore të papaguara në momentin e aplikimit;

d) Huamarrësi nuk duhet të ketë kredi me probleme, me statusin e kredisë 2, 3, 4, 5, 6, në momentin aktual në regjistër kredie;

e) Huamarrësi (aksionari, përfaqësuesi ligjor) nuk duhet të jenë gjykuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për mashtrim, korrupsion, përfshirje në një organizatë kriminale apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme që dëmton interesat financiare të fondeve publike;

f) Huamarrësi nuk duhet të ketë detyrime në historik dhe në momentin aktual ndaj Ministrisë së Financave që rrjedhin nga skema të mëparshme të garancive shtetërore miratuar me:

1) VKM-në nr. 277, datë 6.4.2020, "Për miratimin e garancisë shtetërore të Huas me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga vendimet e këshillit të ministrave, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së mirëkuptimit;

2) VKM-në nr. 387, datë 13.5.2020, "Për miratimin e garancisë shtetërore të Huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së tregtarëve ose shoqërive tregtare për të mundësuar financimin e nevojshëm për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar të ndikuar nga situata e krijuar nga COVID-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit;

3) VKM-në nr. 349, date 26.5.2022, "Për miratimin e garancisë shtetërore të Huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve që tregtojnë me shumicë produkte ushqimore bazë për të mundësuar financimin e nevojshëm për mbajtjen e rezervave me qëllim përballimin e situatës së veçantë të krijuar në treg, si edhe për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit";

4) VKM-në nr. 221, datë 9.4.2024, "Miratimin e garancisë shtetërore të Huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve të industrisë përpunuese, kategoria nace 2, për investime në teknologji dhe inovacion si dhe për blerje të lëndës së parë si edhe për përcaktimin e kushteve e të



kritereve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”;

Huamarrësi dorëzon formularin e vetëdeklarimit për këtë qëllim pranë Huadhënësit.

4. Qëllimi i përdorimit të fondeve të Huas është për t'i mundësuar Huamarrësit fondet e nevojshme për investime për asete fizike dhe teknologjike që rrisin kapacitetet prodhuese, cilësinë e prodhimit dhe eficiencën operationale të tyre.

Në asnjë rast fondet e Huas nuk do të financojnë veprimtari të jashtëligjshme, apo të rfinansojnë hua të tjera.

5. Huamarrësi duhet të nënshkruajë Marrëveshjen e Mirëkuptimit sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar në aneksin 1, pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje. Marrëveshja e Mirëkuptimit duhet të jetë gjithashtu pjesë e kontratës së kreditë si aneks i saj, në momentin e nënshkrimit të Kontratës.

6. Huamarrësi duhet të nënshkruajë formularin e vetëdeklarimit që do t'i vendoset në dispozicion nga Huadhënësit, nëpërmjet të cilit deklaron se fondet e Huas do të përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në pikën 1 dhe pikën 4 të këtij neni. Gjithashtu, në formularin e vetëdeklarimit, Huamarrësi duhet të deklarojë kreditë e aprovuara dhe ato në proces aplikimi/aprovimi në emër të Huamarrësit, të aprovuara apo në proces aprovimi brenda kësaj skeme garancie nga institucionet e tjera huadhënëse.

7. Afati i aplikimit pranë Huadhënësve përfundon më 20.11.2025. Kreditë duhet të disbursohen jo më vonë se 20.12.2025.

8. Huamarrësi duhet të përmbushë kriteret financiare dhe ligjore të përcaktuara në aktet rregullative të bankës përkatëse në të cilën aplikohet për kredi.

9. MF-ja gëzon të drejtën që në çdo moment të rishikojë, shtojë ose heqë çdonjërin prej kritereve të cituara në pikat e mësipërme të këtij neni, në dakordësi me Huadhënësit, ku ndryshimi do të bëhet efektiv pas nënshkrimit të dokumentit ndryshues ndërmjet MF-së dhe Huadhënësve. MF-ja gëzon të drejtën që në çdo moment të zgjatë afatin e parashikuar në pikën 7 të këtij neni, duke vendosur në dijeni paraprakisht Huadhënësit. Ky ndryshim do të bëhet efektiv 10 ditë pune pas marrjes së njofimit me shkrim të MF-së nga Huadhënësit. Asnjë ndryshim i bërë në përputhje me këtë pikë nuk do të ndikojë mbi Huamarrësit, Huaja e të cilëve është

aprovuar përpara datës së bërjes efektive të këtij ndryshimi.

10. Me përjashtim të rasteve siç përcaktohet në pikën 9 të këtij neni, Huadhënësit në asnjë rast nuk do të aprovojnë kërkesat për Hua të Huamarrësve, të cilët nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat 1–7 të këtij neni.

Neni 4

Detyrimet e Huadhënësve

1. Huadhënësit angazhohen të përdorin formularë aplikimi që mundësojnë sigurimin e plotë të të gjithë informacionit të cituar në nenin 3 të kësaj Marrëveshje, në përputhje me praktikat e tij bankare për këto produkte.

2. Huadhënësit mbajnë përgjegjësi për plotësimin e dokumenteve të aplikimit për Hua dhe janë të detyruar të mbajnë kopje të këtyre dokumenteve në arkivat e veta.

3. Huadhënësit do t'i trajtojnë huat që do të jenë pjesë e kësaj Marrëveshje me profesionalizëm dhe në përputhje me kriteret dhe procedurat e brendshme që ato aplikojnë gjatë aktivitetit të tyre të zakonshëm të kredidhënies për produkte bankare tregtare të ngjashme, si edhe në përputhje me përmbajtjen e nenit 3 të kësaj Marrëveshje.

4. Huadhënësit do të bëjnë vlerësimin e rrezikut kredit të Huamarrësve në përputhje me standardet dhe legjislacionin bankar.

5. Huadhënësit duhet të regjistrojnë Huan menjëherë pas lëvrimit në regjistrin e kredive me një emërtim të veçantë në një fushë të posaçme që do të përcaktohet me këtë qëllim. Ky emërtim do të konvertohet në një kod specifik i cili do të përdoret për të identifikuar këto kredi në linjë me rastet e ngjashme.

6. Gjithashtu, Huadhënësit në përputhje me nenin 3, pika 3 dhe pika 6, duhet t'i vendosin në dispozicion Huamarrësit formularin e vetëdeklarimit, sipas formës dhe përmbajtjes që Huadhënësi e gjykon të arsyeshme.

7. Huadhënësit nuk duhet të favorizojnë asnjë Huamarrës mbi bazën e kritereve të tij preferenciale.

8. Huadhënësit duhet të japin në dispozicion të AMGKP-së kopje të të gjitha dosjeve, ekstrakteve, dokumenteve, dhe të dhënave të regjistruara për të gjitha huat që i nënshtrohen kësaj Marrëveshje Garancie.



9. Huadhënësit duhet të shqyrtojnë dokumentacionin e nevojshëm dhe të aprovojë Huan në përputhje me afatet dhe procedurat e brendshme, duke garantuar transferimin e fondeve në llogarinë e Huamarrësit dhe përdorimin e Huas për qëllimet e mbuluara nga garancia shtetërore.

10. Huadhënësit duhet të sigurojnë që të gjitha veprimet dhe vendimet e tij në lidhje me huadhënien dhe menaxhimin e huave të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale bankare dhe financiare të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Termat dhe kushtet e Huas

1. Vlera e Huas e vendosur në dispozicion nga Huadhënësit për Huamarrësin mund të variojë në përputhje me kërkesën e paraqitur nga Huamarrësi, por në asnjë rast totali i kredive të dhëna për huamarrësin nga bankat, sipas kësaj Marrëveshje Garancie, nuk do të jetë më i lartë se 25,000,000 (njëzet e pesë milionë) lekë.

2. Afati i Huas duhet të jetë në diskrecion të Huamarrësit, por ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se 3 vjet dhe duke mos tejkaluar në asnjë rast afatin prej 5 (pesë) vitesh.

3. Huaja të jetë në formën e një produkti të kredisë bankare që të përmbajë një skedul të qartë të shlyerjes së Huas, pra kreditë nuk mund të kenë formën e linjave të kredisë.

4. Huadhënësit, bazuar në vlerësimet e riskut të kreditit për secilin Huamarrës gëzojnë të drejtën që të kërkojnë ose jo kolateral shtesë nga Huamarrësi, por në asnjë rast masa e kërkuar e kolateralit duke përfshirë edhe vlerën e garantuar të Huas sipas kësaj Marrëveshje nuk duhet të tejkalojë mbulimin e përlogaritur sipas legjislacionit dhe rregullave të brendshme të Huadhënësit.

5. Në rastet e parapagimit të Huas, Huadhënësit nuk duhet të aplikojnë komision, penalitet apo çfarëdo lloj mase tjetër që lidhet me parapagimin e Huas.

6. Monedha e Huas është monedha kombëtare lek.

7. Norma e interesit të kredive të kontraktuara dhe disbursuara do të jetë jo më e lartë se 2%. Tarifat e aplikueshme kundrejt huamarrësve për dhënien e kredisë nuk duhet të jenë në total më të larta se niveli maksimal prej 0.5%.

8. Huadhënësit do ta ofrojnë kredinë me një periudhë pa pagesë principali (grace) prej jo më pak se **12 muaj**.

9. Huadhënësit do ta ofrojnë kredinë duke aplikuar penalitete për pagesat e vonuara jo më të larta se penalitetet e përcaktuara në kushtet standarde përkatëse. Huadhënësit nuk do të aplikojnë penalitete për shlyerje të parakohshme të kredisë.

10. Termat dhe kushtet e Huas do të përcaktohen në Marrëveshjen e Huas, e cila do të nënshkruhet ndërmjet Huadhënësve dhe Huamarrësve, në përputhje me përmbajtjen e kësaj Marrëveshje. Termat dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huas, të cilat bien në kundërshtim me këtë Marrëveshje do të konsiderohen të pavlefshme për të përfituar nga garancia shtetërore dhe nuk do të prodhojnë asnjë efekt kundrejt MF-së.

11. Asnjë transferim i të drejtave apo detyrimeve të Huadhënësve që burojnë nga kjo Marrëveshje ose nga Marrëveshja e Huas nuk mund t'i transferohet palëve të treta pa marrë paraprakisht aprovimin me shkrim të MF-së.

12. Për çdo ndryshim, rinovim apo ristrukturim të Marrëveshjes së Huas, që mund të bëhet në marrëveshjen ndërmjet Huadhënësve dhe Huamarrësve brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, nuk është i nevojshëm miratimi i MF-së, me kusht që këto ndryshime nuk do të kenë asnjë efekt në të drejtat e Huadhënësve kundrejt MF-së, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje. Huadhënësit do të njoftojnë me shkrim AMGKP për çdo ndryshim, rinovim apo ristrukturim të Marrëveshjes së Huas brenda një afati prej 10 ditë pune nga nënshkrimi i dokumentit ndryshues.

13. Huadhënësit janë përgjegjës që totali i shumës së vlerës së garantuar të huave, të mos tejkalojë bankave sipas nenit 2 të kësaj Marrëveshje. Në asnjë rast, tejkalimi i vlerës së garancisë nuk do të përbëjë detyrim për MF-në.

14. Huaja do të quhet e përfunduar dhe nuk do të jetë më objekt i kësaj Marrëveshje vetëm pasi të jetë paguar plotësisht nga Huamarrësi në përputhje me termat dhe kushtet e Marrëveshjes së Huas. Huadhënësit duhet të njoftojnë me shkrim AMGKP-së për të gjitha huat e përfunduara brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh kalendarike nga data e përfundimit të tyre.



15. Huadhënësit duhet të njoftojnë me shkrim AMGKP-në për ndryshimin e administratorit të huamarrësit, në rastet e shitjes, dhurimit, transferimit të kuotave të shoqërisë, brenda një afati prej 10 ditë pune nga marrja e njoftimit nga Huamarrësi. Huadhënësit mundësojnë përfshirjen në kontratën e kredisë të detyrimit të huamarrësit për dërgimin e këtij njoftimi.

Neni 6

Procedurat për kryerjen e pagesave të garancisë

1. Kur Huamarrësi nuk ka mundur të kryejë pagesën e detyrimeve që mbulohen nga Garancia (*pagesën e kryegjësë*), dhe kur Huadhënësit brenda një periudhë jo më pak se 180 ditë kalendarike, nga dita e parë e lindjes së detyrimit nga Huamarrësi sipas skedulit fillestar të shlyerjes së *kryegjësë* të përcaktuar në Marrëveshjen e Huas (pra, nga kësti i parë që del me vonesë), kanë ndërmarrë të gjitha hapat e përcaktuara në procedurat dhe politikat e tij të brendshme për ndjekjen e huave të papaguara, atëherë Huadhënësit rezervojnë të drejtën për t'i dërguar AMGKP-së kërkesën me shkrim për pagesën ("Kërkesa për pagesë") e garancisë. Shuma e garancisë duhet paguar në total 70% e kryegjësë së papaguar dhe jo vetëm e këstit /kësteve në vonesë.

2. Kërkesa për pagesë që Huadhënësit do t'i drejtojnë AMGKP-së duhet të përmbajë:

a) Vlerën e pagesës së përlllogaritur në përputhje me pikën 3, të nenit 2, kopje të Marrëveshjes së Huas, si edhe një përshkrim të detajuar të detyrimeve, duke përcaktuar në mënyrë analitike kryegjënë, interesat e akumuluar, penalitetet, dhe çdo detyrim tjetër në zbatim të Marrëveshjes së Huas dhe që është në ngarkim të Huamarrësit, pavarësisht se MF-ja garanton vetëm kryegjënë në masën 70%.

b) Një përshkrim të të gjitha procedurave të ndjekura nga Huadhënësit përgjatë periudhës 180 ditore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të rikuperuar detyrimet nga Huamarrësi, nga momenti i gjenerimit të detyrimit deri në momentin e dërgimit të kërkesës për pagesë.

Kërkesa për pagesë duhet të përmbajë një përshkrim të detajuar të gjitha veprimeve të kryera nga Banka, konkretisht si: tentativa për kontaktimin e huamarrësit, njoftimet drejtuar huamarrësit, procedura ligjore të ndërmarra nga bankat si kërkesë

drejtuar Gjykatës për lëshim urdhri ekzekutimi etj., nga bankat për vjeljen e detyrimit, para thirrjes së garancisë, përgjatë periudhës 180 ditore.

c) Numrin e llogarisë bankare në të cilin do të kryhet pagesa nga MF-ja.

3. AMGKP-ja, pasi vëren se kërkesa për pagesë është në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni dhe kushtet që bëjnë të nevojshme paraqitjen e një kërkesë të tillë sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Huas, përcjell pranë MF-së, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e marrjes së kërkesës për pagesë, njoftimin për pagesë. MF-ja autorizon transfertën e pagesës ose pagesave për Huadhënësit brenda 10 (dhjetë) ditë pune nga data e marrjes së njoftimit për pagesë nga AMGKP-ja.

Nëse AMGKP-ja e vlerëson të arsyeshme, përpara njoftimit për kryerjen e pagesës dhe brenda afateve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, mund të kërkojë informacion shtesë ose qartësime nga Huadhënësit.

4. MF-ja nuk ka asnjë detyrim ndaj kërkesave për pagesë, të cilat mund të burojnë nga vjedhja, materializimi i risqeve operationale të Huadhënësve, ose për çdo arsye tjetër që nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje.

Neni 7

Rikuperimi postpagesës së garancisë

1. Me kryerjen e pagesës së garancisë për ndonjë prej huave, MF-ja merr në dorëzim menjëherë të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, në masën e çdo pagese të kryer nga MF-ja në kuadër të garancisë për këtë Hua, që zotëronin Huadhënësit ndaj Huamarrësve, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Huas. Këto të drejta dhe mjete ligjore i kalojnë MF-së, së bashku me të drejtat dhe mjetet ligjore që ka në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit.

2. MF-ja, nëpërmjet kësaj marrëveshje, autorizon Huadhënësit që të ndjekin, në emër dhe për llogari të MF-së, të gjitha procedurat e rikuperimit dhe ekzekutimit të detyrimeve, në përputhje me procedurat ligjore dhe praktikat e sektorit bankar, për të gjithë shumën e detyrimit të Huamarrësve. Në çdo rast Huadhënësit marrin përsipër të kryejnë të paktën të njëjtat procedura për rikuperimin e detyrimit, ashtu si për detyrimin e vetë Huadhënësve. Huadhënësit janë të detyruar të njoftojnë menjëherë AMGKP-në për çdo veprim procedural të kryer gjatë procedurës së ekzekutimit



vullnetar ose të detyrueshëm, me qëllim që të mos cenohen të drejtat materiale apo procedurale të MF. Përfshirë, palët, me marrëveshje të veçantë, mund të bien dakord që heqin dorë nga ndjekja e procedurave për ekzekutimin e detyrimit, në rastet kur vlerësojnë se kostot e këtyre procedurave tejkalojnë masën e të gjithë detyrimit.

3. Nëse pas 2 (dy) vjetëve nga data e kryerjes së pagesës së garancisë, Huadhënësit nuk kanë mundur të rikuperojnë detyrimet e Huamarrësve, MF-ja zotëron të drejtën që të ndjekë vetë procedurat ligjore për rikuperimin e detyrimeve në masën e çdo pagese të kryer nga MF-ja në kuadër të garancisë për këtë Hua, në përputhje me të drejtat dhe mjetet ligjore që ka në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit.

4. Nëse pas pagesës së garancisë nga MF-ja për ndonjë prej huave, Huadhënësit brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni rikuperojnë një pjesë ose të gjithë detyrimin e Huas (duke përfshirë edhe rikuperimin nëpërmjet ekzekutimit të kolateralit, nëse ka një të tillë) që paraprakisht është paguar nga garancia, Huadhënësit brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune duhet të njoftojnë me shkrim MF-së dhe AMGKP-së në lidhje me vlerën e rikuperuar, procedurat e rikuperimit, shpenzimet e rikuperimit, si dhe vlerën e interesave dhe kamatave ligjore që duhet të paguhet dhe çdo detaj tjetër që gjykojnë të arsyeshëm në lidhje me rikuperimin.

Menjëherë pas marrjes së njoftimit, MF-ja udhëzon me shkrim Huadhënësit në lidhje me detajet e pagesës. Afati për kryerjen e pagesës nga Huadhënësit në favor të MF-së do të jetë si më poshtë:

a) Në rastin kur rikuperimi është në formën e mjeteve monetare (*cash*), pagesa do të kryhet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e marrjes së instruksioneve me detajet e pagesës nga MF-ja, pasi Huadhënësit të kenë zbritur më parë detyrimin e kredisë, për pjesën e pambuluar me garanci, si dhe çdo shpenzim të akumuluar për rikuperim.

b) Në rastin kur rikuperimi nuk është në formën e mjeteve monetare, pagesa do të kryhet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e konvertimit të rikuperimit në mjete monetare (*cash*). Konvertimi i rikuperimit në mjete monetare (*cash*) do të kryhet në përputhje me procedurat dhe politikat e Huadhënësve për këtë qëllim.

5. Vlera që Huadhënësit paguajnë në favor të MF-së, në rast të rikuperimit të detyrimit të Huamarrësve nga Huadhënësve pas pagesës së garancisë, është e barabartë me vlerën e rikuperuar pasi t'i jenë zbritur shpenzimet për rikuperimin e Huas, dhe ku vlera e mbetur pasi janë zbritur interesat e papaguara, kamatat ligjore sipas K.Pr.Civile, si dhe shpenzimet ligjore e përmbartimore të kryera nga Huadhënësit, të ndahet ndërmjet Huadhënësit dhe MF-së në raportet përkatësisht prej 30% për huadhënësit dhe 70% për MF-në, me përjashtim të rastit kur rikuperimi është mundësuar nga kolateral i vënë për kredinë sipas nenit 5, pika 4, të kësaj marrëveshjeje. Në këtë rast, Huadhënësit paguajnë në favor të MF-së vlerën e mbetur pasi ka mbajtur plotësisht detyrimet e Huamarrësve kundrejt Huadhënësve.

6. Në rast se Huamarrësit, përveç detyrimit që buron nga Huaja nën këtë Marrëveshje Garancie kanë edhe detyrime të tjera ndaj Huadhënësve, atëherë ndjekja e detyrimit që buron nga kjo Hua ndiqet njëkohësisht me ndjekjen e detyrimeve të tjera, pa asnjë lloj diskriminimi nga Huadhënësit, pa cenuar rankimin e kredive dhe kushtet e huave dhe garancive respektive, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Raportimi dhe monitorimi

1. Huadhënësit do të raportojnë në formë elektronike pranë AMGKP-së, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendrike nga mbyllja e secilit muaj, për huat e aprovuara prej tyre në muajin paraardhës, duke përcjellë shumën e disbursuar, skedulin e amortizimit të huave, Marrëveshjen e Mirëkuptimit origjinale, si edhe kopje të dokumenteve shoqëruese që vërtetojnë kriteret e kualifikimit të Huamarrësve dhe kriteret për përfitimin e Huas sipas nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Huadhënësit gjithashtu do të raportojnë në formë elektronike dhe shkresore në bazë mujore pranë AMGKP-së, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendrike nga mbyllja e secilit muaj, ecurinë e shlyerjes së Huas, duke përfshirë në raportim informacion në lidhje me pagesat e kryera të Huas nga Huamarrësi dhe vlerën e mbetur të Huas.

3. Huadhënësit angazhohen të raportojnë në mënyrë periodike (çdo muaj) pranë AZHBR-së, të dhënat e detajuara mbi aplikantët (fermerë dhe



subjekte), si dhe përfituesit në kuadër të skemës së garancisë shtetërore. Raportimi do të përfshijë informacionin mbi numrin e kredive të dhëna, llojin e investimit, shumën e financimit, statusin e kredive dhe çdo element tjetër të nevojshëm për vlerësimin e ecursisë së skemës.

4. Raportimet në lidhje me këtë nen, si dhe komunikimet për nenet e tjera të kësaj Marrëveshje duhet të bëhen në formë elektronike ose me shkrim sipas rasteve të përcaktuara në nenet përkatëse. Ato duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për Ministrinë e Financave:

[Adresa]
Në vëmendje të:
Faks:

Për AMGKP:

[Adresa]
Në vëmendje të:
E-mail:
Faks:

Për:

- Banka Raiffeisen sh.a.

[Adresa]
Në vëmendje të:
E-mail:
Faks:

- Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.

[Adresa]
Në vëmendje të:
E-mail:
Faks:

- Banka Kombëtare Tregtare sh.a.

[Adresa]
Në vëmendje të:
E-mail:
Faks:

- Banka Tirana sh.a.

[Adresa]
Në vëmendje të:
E-mail:
Faks:

- Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a.

[Adresa]
Në vëmendje të:
E-mail:
Faks:

- Banka Procredit sh.a.

[Adresa]
Në vëmendje të:
E-mail:
Faks:

- Banka Amerikane e Investimeve sh.a.

[Adresa]
Në vëmendje të:
E-mail:
Faks:

- Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a.

[Adresa]
Në vëmendje të:
E-mail:
Faks:

- Banka Credins sh.a.

[Adresa]
Në vëmendje të:
E-mail:
Faks:

- Banka OTP Albania sh.a.

[Adresa]
Në vëmendje të:
E-mail:
Faks:

- Banka Union sh.a.

[Adresa]
Në vëmendje të:
E-mail:
Faks:

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje, kundërshti apo pretendim që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, apo shkelja, zgjidhja ose pavlefshmëria e saj, do të zgjidhet me mirëkuptim nga palët. Nëse palët nuk arrijnë t'i zgjidhin ato me mirëkuptim, zgjidhja e tyre do t'i nënshtrohet juridiksionit të gjykatës administrative shqiptare.

Neni 10

Vlefshmëria e dispozitave

Nëse ndonjëra nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është apo bëhet e pavlefshme, ose në rast se ka ndonjë boshllëk në ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Hyrja në fuqi dhe efektiviteti

Kjo Marrëveshje Garancie do të hyjë në fuqi, pas nënshkrimit nga palët dhe do të bëhet efektive pas disbursimit të Huas ndërmjet Huadhënësve dhe Huamarrësve.

Neni 12

Nënshkrimi

Palët nënshkruajnë këtë Marrëveshje në () kopje origjinale të barasvlershme në gjuhën shqipe (një kopje për MF-në dhe nga një kopje për secilin nga Huadhënësit), në Tiranë, Shqipëri, në datat e përcaktuara në krye të kësaj Marrëveshjeje.



Neni 13

Përfundimi dhe pezullimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje Garancie do të quhet e përfunduar kur të gjitha detyrimet ndërmjet palëve, të cilat burojnë nga Marrëveshja e Huas dhe kjo Marrëveshje të jenë përmbushur plotësisht, në rast se nuk do të kërkohet përfundimi përpara kohe i saj nga ana MF-ja ose Huadhënësve.

2. MF-ja mund të pezullojë Marrëveshjen e Garancisë në çdo kohë, duke e njoftuar me shkrim Huadhënësit, në rast se MF-ja vërteton se Huadhënësit kanë kryer një shkelje të kësaj Marrëveshje, ose është përfshirë në një mashtim, i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë te MF-ja.

3. Përfundimi apo pezullimi i kësaj Marrëveshje nuk do të ketë efekt mbi huat që janë disbursuar në përputhje me kushtet e marrëveshjes deri në datën e hyrjes në fuqi të përfundimit apo pezullimit. Huat e disbursuara në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Garancisë do vijojnë të jenë të garantuara nga kjo garanci shtetërore deri në përmbushjen e plotë të detyrimeve të Huamarrësve.

**KËSHILLI I MINISTRAVE
PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE**
Petrit MALAJ

- Banka Raiffeisen sh.a.
ADMINISTRATOR

- Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.
ADMINISTRATOR

- Banka Kombëtare Tregtare sh.a.
ADMINISTRATOR

- Banka Tirana sh.a.
ADMINISTRATOR

- Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a.
ADMINISTRATOR

- Banka Procredit sh.a.
ADMINISTRATOR

- Banka Amerikane e Investimeve sh.a.
ADMINISTRATOR

- Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a.
ADMINISTRATOR

- Banka Credins sh.a.
ADMINISTRATOR

- Banka OTP Albania sh.a.
ADMINISTRATOR

- Banka Union sh.a.
ADMINISTRATOR

ANEKSI 1

**MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI
(FORMAT TIP)**

Bazuar në nenin 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 676, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar:

[Emërtimi i Huamarrësisë] bie dakord të nënshkruaj këtë Marrëveshje Mirëkuptimi në datën _____.____.2025 për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga lëshimi i Garancisë Shtetërore të Huas, sipas Marrëveshjes së Garancisë nr. _____, datë _____.____.2025.

Në rast kompensimi të humbjeve nga MF-ja për pagesa që burojnë nga Marrëveshja e Huas sipas Marrëveshjes së Garancisë cituar në paragrafin e mësipërm, [emërtimi i Huamarrësisë] në zbatim të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të Marrëveshjes së Mirëkuptimit, është i detyruar t’i kthejë Ministrisë së Financave shumën që kjo e fundit i ka paguar huadhënësit, në kuadër të garancisë shtetërore të huas, përfshirë dhe të gjitha kostot që mund të lidhen me të.

Në rast të kundërt, [emërtimi i Huamarrësisë] është në dijeni dhe pranon shprehimisht se MF-ja ka të drejtën për të ndërmarrë të gjitha masat e përcaktuara në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si edhe në ligje të tjera në fuqi, dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për të përfituar nga [emërtimi i Huamarrësisë] çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të, si dhe kthimin e çdo kompensimi të kryer sipas marrëveshjes së garancisë; si dhe që Marrëveshja e Mirëkuptimit përbën akt në kuptimin e nenit 510, pika “d”, të Kodit të Procedurës Civile,



duke u siguruar që të përmbushë elementet e kërkuara nga dispozita e sipërcituar.

[Emërtimi i Huamarrësit]

Nënshkrimi

ANEKSI 2 SEKTORËT DHE INVESTIMET E MBËSHTETURA

Sektorët të cilët do të mbështeten së bashku me investimet përkatëse nga kjo skemë do të jenë, si më poshtë:

- Fondi përdoret në sektorin e diversifikimit të fermës dhe agropërpunimit nëpërmjet:
 - ndërtim dhe/ose rindërtim, zgjerim dhe modernizim të ndërtesave bujqësore/blegtorale, duke përfshirë pajisjet;
 - ndërtim dhe/ose rindërtim i serrave duke përfshirë edhe instalimet/teknologjitë;
 - ndërtim dhe/ose rindërtim, zgjerim dhe modernizimi i objekteve që kontribuojnë në objektivat mjedisore dhe ekonominë qarkulluese;
 - makineri/mekanikë dhe pajisje bujqësore/blegtorale;
 - makineri dhe pajisje për prodhimin e energjisë së rinovueshme në fermë;
 - ndërtim dhe/ose rindërtim, zgjerim dhe modernizim për përpunim dhe tregtim të produkteve bujqësore, agrorëshqimore dhe të peshkimit;
 - investime në turizëm rural dhe atë të natyrës;
 - investime në krijimin dhe zgjerimin e fermave të akuakulturës duke përfshirë pajisjet;
 - investime në sistemet e menaxhimit të mbetjeve në sektorin e diversifikimit të fermës dhe agropërpunimit;
 - investime në ndërtim/rindërtim i objekteve dhe ambienteve për popullsinë dhe bizneset rurale, artizanati dhe manifaktura.

2. Infrastrukturë prodhimi, duke synuar shtimin e sipërfaqeve të fermës në prodhimin dhe përpunimin e fruta-perimeve, vreshtave etj. (bujqësia), si edhe fermave në sektorin e qumështit dhe mishit (blegtoria).

3. Agropërpunimi në sektorë të ndryshëm, duke nisur nga nxitja e rritjes së prodhimit të ullirit dhe përpunimit të tij; produktet në sektorin e bimëve medicinale dhe aromatike; produktet e tjera ushqimore që nxisin lidhjen në zinxhir të fermerëve

dhe sektorit të turizmit në promovimin e prodhimeve shqiptare etj.

4. Mbështetje për sektorin e peshkimit dhe akuakulturës.

5. Investime në agroturizëm dhe turizëm rural.

6. Inovacion dhe nxitje të mekanikës bujqësore për automatizimin e mëtejshëm të proceseve të prodhimit.

VENDIM

Nr. 464, datë 31.7.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 607, DATË 31.8.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT (AKKSHI)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 12 e 13, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “b”, e pikës 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Shpërndarjen e fondeve për programet e kërkimit shkencor, mbi bazën e projekteve të paraqitura nga institucionet e arsimit të lartë, institucionet publike e jopublike dhe punonjësit kërkimorë-shkencorë, që kanë për objekt të veprimtarisë kërkimin shkencor në fushat e shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale e humane.”.

b) Pas shkronjës “e”, të pikës 4, shtohet shkronja “ë”, me këtë përmbajtje:



“ë) shpërndarjen e fondeve, bazuar në kriteret e miratuara nga bordi i administrimit, sipas marrëveshjeve të përbashkëta ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, vendase dhe të huaja, në kuadër të ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.”.

c) Paragrafi i parë dhe shkronja “a”, të pikës 8 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“8. Bordi i administrimit është organ kolegjal vendimmarrës, që kryesohet nga ministri përgjegjës për shkencën dhe kërkimin shkencor ose zëvendësministri i autorizuar prej tij dhe ka në përbërje:

a) ministrin përgjegjës për inovacionin;”.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

**VENDIM
Nr.469, datë 31.7.2025**

**PËR EMËRIMIN E TRE ANËTARËVE
TË KOMISIONIT KOMBËTAR TË
PËRZGJEDHJES PËR TND-NË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin, si anëtarë të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në, të:

a) z. Aleksandër Xhuvani për një mandat 5-vjeçar, duke filluar nga data 28.8.2025;

b) znj. Eglantina Zyka për një mandat 5-vjeçar, duke filluar nga data 28.8.2025;

c) znj. Klesta Hysi, e cila do të qëndrojë në detyrë deri në datën 19.1.2027, datë në të cilën përfundon mandati i ish-anëtarit të KKP-së, z. Erind Mërkuri.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Faqe | 19854

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

**VENDIM
Nr. 470, datë 31.7.2025**

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË
TND EDHE PËR KANDIDATË TË
TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL DHE
PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË
TND, PËR VITIN 2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 27, pika 5, dhe 29, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në vijim të pikave 2, 3 e 4, të kreut V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfundimisht, për vitin 2025, procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND është e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND.

2. Për vitin 2025, pranimi në TND bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet një konkursi kombëtar.

3. Numri i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND, është 15 (pesëmbëdhjetë).

4. Kriteret minimale të pranimit për këtë procedurë për kandidatët nga jashtë shërbimit civil janë, si më poshtë vijon:

a) Të plotësojnë kushtet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar;

b) Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional të përfutur në



fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike”, ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;

c) Të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë punë në pozicione të mesme drejtuese ose të barasvlershme në:

i. institucione të administratës publike;

ii. institucione bankare të nivelit të dytë e që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;

iii. shoqëri tregtare, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohen si biznes i madh e që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;

iv. organizata jofitimprurëse, të cilat kanë të paktën 5 (pesë) vjet që janë krijuar.

ç) Të mos kenë procese gjyqësore, civile, penale, administrative, të cilat janë në proces, si edhe të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria;

d) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi, që nuk janë shuar sipas legjislacionit përkatës.

5. Përfshihet, për kandidatët nga jashtë shërbimit civil, të cilët kanë punuar dhe/ose punojnë:

a) në institucione ndërkombëtare brenda vendit;

b) në profesione jashtë vendit;

c) pedagogë në institucione të arsimit të lartë;

ç) avokatë, noterë apo kontabilistë, të miratuar brenda ose jashtë vendit,

kriteri i përvojës në punë të jetë të paktën 5 (pesë) vjet në këto institucione ose në profesion.

6. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 471, datë 31.7.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 142, DATË 12.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRSHKRIMIN DHE KLASIFIKIMIN E POZICIONEVE TË PUNËS NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE DHE INSTITUCIONET E PAVARURA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 69, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 18, të kreut IV, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave apo nëpunësi i caktuar prej tij për Kryeministrinë dhe institucionet në varësi të Kryeministrit;

...

c) Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë apo nëpunësi i caktuar prej tij për ministrinë dhe institucionet në varësi të ministrit;”.

2. Ngarkohen Kryeministria, ministrinë e linjës dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**VENDIM****Nr. 473, datë 31.7.2025****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE SHITESAVE TË TJERA MBI PAGË TË ZËVENDËSMINISTRIT, FUNKSIONARËVE TË KABIN ETEVE, PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT, NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, të shkronjës “h”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në shkronjën “c”, të pikës 1, të kreut I, emërtimi “Inspektorati Qendror” zëvendësohet me “Inspektorati i Përgjithshëm”;

b) Në pikën 8/1, të kreut III, fjalët “ ... në Inspektoratin Qendror ... ” zëvendësohen me “ ... në Inspektoratin e Përgjithshëm ... ”;

c) Në lidhjen nr. 9/1:

i. fjalët “ ... në Inspektoratin Qendror ... ” zëvendësohen me “ ... në Inspektoratin e Përgjithshëm ... ”;

ii. fjalët “ ... Drejtor i drejtorive të përmbajtjes.” zëvendësohen me “ ... Zëvendësinspektor i përgjithshëm. Drejtor i drejtorive të përmbajtjes.”;

iii. fjalët “ ... Specialist një njësitë e përmbajtjes.” zëvendësohen me “ ... Inspektor/specialist një njësitë e përmbajtjes.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2025, përballohen nga buxheti i miratuar për Inspektoratin e Përgjithshëm për këtë vit dhe fillojnë nga momenti i emërimit të nëpunësve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Belinda Balluku****VENDIM****Nr. 41, datë 24.6.2025****NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 4.6.2025 dhe 24.6.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 19 (F) 2024 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Fatos Gjini, përfaqësuar nga avokat Arseni Mema, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Policisë e Qarkut Vlorë, Komisariati i Policisë Delvinë, të përfaqësuar me autorizim nga juriste Ergita Shanaj.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-3138 (393), datë 22.11.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.



BAZA LIGJORE: Nenet 42, 49, 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit Fatos Gjini (*kërkuar*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Drejtorisë së Policisë të Qarkut Vlorë (DPQ) dhe Komisarariatit të Policisë Delvinë (*Komisariati i Delvinës*), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuar ka qenë në marrëdhënie pune në DPQ-në, Vlorë, me detyrë “ndihmëspecialist” në Komisariatin e Delvinës sipas urdhrit nr. 7/4, datë 5.1.2009, të DPQ-së, Vlorë. Me urdhrin nr. 57/20, datë 23.4.2014 të DPQ-së, Vlorë, kërkuar është liruar nga detyra me motivacionin se është pranuar në radhët e policisë në kundërshtim me kriteret ligjore, pasi ka qenë edhe më parë i përjashtuar, sipas nenit 57, pika 1, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit” (*ligji nr. 9749/2007*), neneve 46 dhe 62, pika 5, shkronja “ç”, të “Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit”, “Procedurat Standarde për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore”, të miratuar me urdhrin nr. 1277, datë 11.11.2009, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Duke mos qenë dakord me këtë akt, në datën 5.5.2014, kërkuar i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, kundërdrejtuar DPQ-së, Vlorë dhe Komisarariatit të Delvinës, me objekt: i. shfuqizimin e urdhrit nr. 57/20, datë 23.4.2014 të DPQ-së, Vlorë; ii. rikthimin në detyrë; iii. detyrimin e palës së paditur t’i paguajë pagën.

3. Me vendimin nr. 421, datë 19.6.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë ka

pranuar pjesërisht padinë, duke detyruar DPQ-në, Vlorë t’i paguajë kërkuarit 12 paga mujore dëmshpërblim për lirimin nga detyra. Për kërkimin për shfuqizimin e urdhrit të lirimimit dhe rikthimin në detyrë të kërkuarit, ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e padisë, pasi ligji specifik nuk parashikon kthimin në detyrë.

4. Për ankimin e palës së paditur, DPQ-së, Vlorë, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1122, datë 21.5.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë vetëm për kërkimin e parë të padisë, duke shfuqizuar urdhrin nr. 57/20, datë 23.4.2014, të DPQ-së, Vlorë, me arsyetimin se shkaku i ndërprerjes së marrëdhënies së punës është i pambështetur në ligj. Sipas saj, gjykata e shkallës së parë duhet të kishte vendosur shfuqizimin e urdhrit të lirimimit dhe zgjidhjen e pasojave. Kundër këtij vendimi, në datën 15.6.2015, ka paraqitur rekurs pala e paditur në procesin gjyqësor, DPQ-ja, Vlorë.

5. Pas vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, me urdhrin nr. 603/1, datë 4.4.2022, “Për rikthimin në Policinë e Shtetit dhe emërimin në detyrë të z. Fatos Gjini”, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe urdhrin nr. 750, datë 6.4.2022, “Për rikthimin në Policinë e Shtetit dhe emërimin në detyrë të z. Fatos Gjini”, të drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, është bërë rikthimi i kërkuarit në Policinë e Shtetit dhe emërimi në detyrë si oficer i Patrullës së Përgjithshme Shqiptonja/Motorist në Seksionin e Rendit Publik, në Komisariatin e Policisë Sarandë në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë.

6. Ndërkohë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3138 (393), datë 22.11.2022, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimin e padisë, me arsyetimin se bazuar në ligjin nr. 9749/2007 dhe VKM-në nr. 804, datë 21.11.2007, “Rregullorja e personelit të Policisë së Shtetit”, dalë në zbatim të këtij ligji, personat e përjashtuar nga policia nuk kanë të drejtë rikthimi në strukturat e policisë, përveç rastit kur akti i përjashtimit është: i. revokuar ose shfuqizuar nga vetë organi publik; ii. shfuqizuar ose deklaruar absolutisht i pavlefshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat e faktit kanë interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin material të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.



7. Në vijim, me urdhrin nr. 5695, datë 17.10.2024, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, kërkuesi është liruar nga detyra.

8. Në datën 11.11.2024, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në datën 21.1.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në seancën plenare mbi bazë të dokumenteve të datës 4.6.2025, Gjykata ka vendosur shtyrjen e saj me qëllim kërkimin e informacionit dhe të materialeve shtesë nga kërkuesi, si dhe nga subjektet e interesuara.

9. Në vijim, Gjykata ka bërë njoftimin e palëve, për caktimin e seancës plenare mbi bazë të dokumenteve në datën 24.6.2025.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar:

10.1 *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

10.1.1 *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë i ka mohuar të drejtën për të paraqitur kundërrekurs dhe parashtrime përpara seancës gjyqësore, për shkak të moskomunikimit të rekursit të palës së paditur, ndonëse në vendimin e saj ajo gjykatë shprehet, ndër të tjera, se rekursi i është komunikuar rregullisht palës paditëse (kërkuesit) dhe se ai nuk ka paraqitur kundërrekurs për mbrojtjen e tij.

10.1.2 *Së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar, për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar*, pasi Gjykata e Lartë me mosnjoftimin e rekursit i ka hequr të drejtën të ndjekë vijueshmërinë e çështjes së tij, ndërsa kërkuesi është njohur me vendimin e saj vetëm pas urdhrit të lirimit të tij nga detyra.

10.2 *Të drejtën për punë dhe për të fituar mjetet e jetesës*, të parashikuar nga neni 49 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi aktet që e hiqnin kërkuesin nga puna.

11. **Subjektet e interesuara**, DPQ-ja, Vlorë dhe Komisariati i Delvinës, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se rekursi i paraqitur prej tyre nuk paraqet të meta, ndërkohë që detyrimin për të njoftuar palët ndërgjyqëse e ka Gjykata e Lartë. Në vijim të vendimarrjes së Kolegjit Administrativ,

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është venë menjëherë në lëvizje për ndjekjen e procedurave ligjore për ekzekutimin e vendimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “P”, të pikës 1, të nenit 131 dhe shkronjës “I”, të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

14. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

15. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se pretendimi kryesor i kërkuesit lidhet me faktin që nuk ka marrë dijeni për rekursin e subjektit të interesuar dhe rrjedhimisht as për procesin dhe vendimarrjen e Gjykatës së Lartë, si



dhe faktin që në dosjen gjyqësore nuk ka ndonjë akt që të provojë njoftimin e tij, çmon të konsiderojë si momentin nga i cili ka filluar të ecë afati ligjor 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues datën 17.10.2024, kur kërkuesi parashtroi se i është komunikuar urdhri i lirimit nga detyra në ekzekutim të vendimit të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

16. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka ngritur disa pretendime për procesin e zhvilluar nga Gjykata e Lartë në drejtim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar, për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar, për shkak se nuk është njoftuar për rekursin e palës kundërshtare në proces, duke i hequr mundësinë për të paraqitur kundërrekurs dhe parashtrime përpara seancës gjyqësore, si dhe të ndjekë vijueshmërinë e çështjes së tij. Sipas tij, kjo i ka cenuar të drejtën për të fituar mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme. Nisur nga thelbi i pretendimeve, Gjykata çmon t'i analizojë ato në drejtim të së drejtës së aksesit substancial lidhur me të drejtën për t'u njoftuar dhe për t'u mbrojtur.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar dhe për t'u mbrojtur

17. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka mohuar të drejtën për të paraqitur kundërrekurs dhe parashtrime përpara seancës gjyqësore, për shkak të moskomunikimit të rekursit të palës së paditur, ndonëse në vendimin e saj ajo gjykatë shprehet, ndër të tjera, se rekursi i është komunikuar rregullisht palës paditëse (kërkuesit) dhe se ai nuk ka paraqitur kundërrekurs për mbrojtjen e tij. Po kështu, sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë me mosnjoftimin e rekursit i ka hequr të drejtën të ndjekë vijueshmërinë e çështjes së tij, pasi është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë vetëm pas lëshimit të urdhrit të lirimit nga detyra. Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi aktet që e hiqnin atë nga puna.

18. Subjektet e interesuara kanë pretenduar se rekursi i paraqitur prej tyre nuk paraqet të meta, ndërkohë që detyrimin për të njoftuar palët ndërgjyqëse e ka Gjykata e Lartë, si dhe në vijim të vendimmarrjes së Kolegjit Administrativ, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është vënë menjëherë në lëvizje për ndjekjen e procedurave ligjore për ekzekutimin e vendimit.

19. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje Gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 31, datë 3.11.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti në të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 37, datë 30.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. E drejta e palës për t'u njoftuar për argumentet e faktet e parashtruara në ankimin e palës tjetër është pjesë e së drejtës së individit për një proces të rregullt, nëpërmjet së cilës atij i krijohet mundësia të përgatisë mbrojtjen e vet e të parashtrtojë argumentet ndaj pretendimeve të palës tjetër (*shih vendimet nr. 18, datë 4.4.2023; nr. 5, datë 26.1.2007; nr. 15, datë 13.7.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë të dokumenteve, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së



mbrojtjes dhe të parimit të barazisë së armëve në gjykim. Vetëm njoftimi me shpallje nuk nënkupton përmbushjen e detyrimit të sekretarisë së Gjykatës së Lartë për njoftimin e rregullt të palëve, në mënyrë që ato të mund të marrin pjesë në gjykim, si dhe të dëgjohen e të mbrohen me anë të paraqitjes së komenteve ose prapësimeve. (*shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2023; nr. 28, datë 1.11.2022; nr. 21, datë 4.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata vëren se referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për efekt të këtij shqyrtimi, konstatohet se pas përfundimit të gjykimit në gjykatën e apelit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, me dëftesën e komunikimit nr. 329 akti, datë 19.6.2015, i ka dërguar kërkuessit një kopje të rekursit të palës së paditur në adresën e vendbanimit të tij në Metoq, Sarandë (marrë nga të dhënat e kërkuessit në kërkesëpadi). Dëftesa e komunikimit është nënshkruar për efekt të marrjes dijeni nga shtetasja E. B. në datën 2.7.2015. Në vijim, pas më shumë se 7 vjetëve nga paraqitja e rekursit, në datën 4.11.2022 gjyqtari relator në Gjykatën e Lartë ka caktuar datën 22.11.2022 për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, duke urdhëruar sekretarinë e gjykatës të bëjë njoftimin e palëve. Në datën 4.11.2022 Gjykata e Lartë ka shpallur listën e çështjeve administrative për shqyrtim në dhomën e këshillimit në datën 22.11.2022, përfshirë edhe çështjen e kërkuessit. Gjithashtu, njoftimi për shqyrtimin e çështjes së kërkuessit rezulton të jetë shpallur edhe në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë në rubrikën “*Lista e çështjeve administrative për shqyrtim*” në dhomën e këshillimit, datë 22.11.2022. Në procesverbalin e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, që mban datën 22.11.2022, ora 10:50, është shënuar se palët janë njoftuar rregullisht.

24. Gjykata vëren se më herët Gjykata Administrative e Apelit i ka dërguar kërkuessit kopje të vendimit të saj me njoftim vendimi nr. 7193/2635 akti, datë 2.6.2015, i cili rezulton i nënshkruar për marrje dijeni nga shtetasja E. Ç. në datën 2.6.2015 me shënimin “*Vendimi është tërhequr në sekretari*”. Ndërkohë dëftesat e komunikimit nr. 376 akti, datë 23.6.2014 dhe nr. 376 akti, datë 21.7.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë rezultojnë të nënshkruara për marrje dijeni nën emrin e kërkuessit në datën 9.7.2014 dhe në datën 23.7.2014.

25. Në analizë të fakteve të mësipërme, Gjykata konstaton se për sa i takon njoftimit të akteve gjyqësore, nenet 130 dhe 131 të Kodit të Procedurës Civile, sipas përmbajtjes së tyre në kohën e depozitimit të rekursit (datë 19.6.2015), si rregull, parashikonin njoftimin me shkresë, që konsistonte në dorëzimin e kopjes së aktit të njoftimit personit që përcaktohej si marrës, kudo ku ai gjendej dhe, në pamundësi, njoftimi bëhej në vendbanimin ose vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën, ose vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale ose të artizanatit, duke ia dorëzuar aktin personalisht marrësit, një personi të familjes që ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, fqinjëve që pranojnë t’ia dorëzojnë atë marrësit, zyrës ose qendrës së punës së tij ose portierit të ndërtesës së banimit, të zyrës, ose të qendrës së punës. Në rastin konkret, kërkuessit i është dërguar vendimi i gjykatës së apelit dhe rekursi në adresën e caktuar nga ai në kërkesëpadi, nëpërmjet dëftesave të komunikimeve përkatëse, të cilat te rubrika e marrjes dijeni janë nënshkruar nga dy persona të ndryshëm, për të cilët nuk ka informacion të lidhjes së tyre me kërkuessin. Me shkresën e datës 11.6.2025, përfaqësuesi ligjor i kërkuessit, në përgjigje të informacionit të kërkuar, ka informuar Gjykatën se as kërkuessi e as ndonjë pjesëtar ose i afërm i tij nuk ka marrë dijeni dhe as ka firmosur dëftesën e komunikimit nr.329 akti, datë 19.6.2025, si dhe shtetasja E. B., e cila ka firmosur këtë dëftesë komunikimi, nuk njihet nga kërkuessi ose nga ndonjë pjesëtar, apo i afërm i tij. Ky pretendim nuk është kundërshtuar nga subjektet e interesuara.

26. Gjykata vëren se bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, kërkuessi nuk është njoftuar për rekursin e palës së paditur, DPQ-së Vlorë, duke u vënë kështu në pamundësi objektive jo vetëm për të marrë dijeni për vënien në lëvizje të procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, por edhe për të ushtruar të drejtat e tij që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, pra për të paraqitur, përmes kundërrekursit ose parashtrimeve në proces, pretendime në mbrojtje të interesave të tij ligjorë e kushtetues. Edhe pse Gjykata e Lartë ka detyrimin të verifikojë, në këndvështrim të garantimit të së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve, nëse administrata gjyqësore ka marrë masat për të kryer njoftimin e rekursit palëve ndërgjyqëse, ajo nuk është ndaluar në kryerjen e këtij vlerësimi.



27. Në kuptim të sa më sipër, pra të pasojave që i kanë ardhur kërkuessit nga mosnjofitimi i rekursit, Gjykata vlerëson se njofitimi i akteve me të cilat vihet në lëvizje një proces gjyqësor ka rëndësi në drejtëm të pjesëmarrjes së individit në gjykim dhe të realizimit të të drejtave të tij kushtetuese. Po kështu, njofitimi në kohën e duhur i akteve gjyqësore përbën një garanci të domosdoshme si për të vënë në dijeni individin për procesin gjyqësor ku ai është palë, ashtu edhe për të garantuar pjesëmarrjen e tij në proces dhe ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes dhe përdorimit të mjeteve procedurale në funksion të mbrojtjes së tij, siç është kundërrekursi ose prapësimet ndaj pretendimeve të palës tjetër në proces.

28. Gjykata thekson se pavarësisht se në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë kjo e fundit, përmes administratës gjyqësore, ka kryer njoftimin e datës së zhvillimit të seancës gjyqësore në përputhje me parashikimet procedurale të zbatueshme në atë gjykim, kjo nuk është e mjaftueshme për të korrigjuar dhe për të riparuar të metat e evidentuara në drejtëm të njofimit të rekursit, të cilat kanë sjellë si pasojë humbjen nga ana e kërkuessit të së drejtës për të paraqitur kundërrekurs dhe argumente ligjore në kundërshtim të pretendimeve të palës kundërshtare, si dhe për të parashtruar qëndrimin dhe pretendimet e saj për zgjidhjen e çështjes. Mënyra sesi kanë vepruar gjykatat, në rastin konkret, e kanë vënë kërkuessin në pamundësi të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes ndaj shkaqeve të rekursit dhe në këtë mënyrë procesi nuk ka garantuar respektimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

29. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se mangësitë në njoftimin e rekursit dhe pasojat që kanë sjellje ato përbejnë shkelje thelbësore që e bëjnë procesin të parregullt në kuptimin kushtetues, për sa kohë kanë pasur ndikim në të drejtën e aksesit të kërkuessit, pra në të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare për pretendimet e tij, për rrjedhojë edhe në të drejtën për t'u dëgjuar në atë gjykatë në respektim të parimit të barazisë së armëve. Për sa më lart, Gjykata çmon se shkeljet e konstatuara kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke e bërë atë proces të parregullt në kuptimin kushtetues, ndaj pretendimi i kërkuessit është i bazuar.

30. Në përfundim Gjykata çmon se pretendimet e kërkuessit janë të bazuara, sipas arsytimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-3138 (393), datë 22.11.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtuesshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 24.6.2025.

Shpallur më 28.7.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim

VENDIM

Nr. 147, datë 8.7.2025

MBI KËRKESËN E “TAP AG” PËR PËRJASHTIMIN NGA ZBATIMI I STANDARDIT ISO 27001

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 13, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të ligjit nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 553, datë 15.7.2020, “Për miratimin e listës së infrastrukturës së informacionit kritik dhe të rëndësishëm”, të ndryshuar me VKM-në nr. 761, datë 12.12.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 553, datë 15.7.2020, të



Këshillit të Ministrave”; të “Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturës kritike në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 126, datë 30.7.2020; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, të ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1940/1 prot., datë 3.7.2025, të Sektorit të Sigurisë Kibernetike dhe IT-së “Mbi kërkesën e ‘TAP AG’ për moszbatimin e standardit ISO 27001”,

konstatoi se:

- Shoqëria “TAP AG”, me shkresën e saj nr. 1940 prot., datë 25.6.2025, i është drejtuar ERE-s me një kërkesë për moszbatimin e detyrimit për t’u certifikuar sipas standardit ISO/IEC 27001, të përcaktuar në “Rregulloren për sigurinë kibernetike të infrastrukturës kritike në sektorin e energjisë”.

- “TAP AG” ka argumentuar se, për shkak të karakterit ndërkufitar të veprimtarisë së saj dhe klasifikimit të saj si subjekt thelbësor në kuadër të direktivës (BE) 2022/2555 (NIS2), ajo i nënshtrohet mbikëqyrjes nga autoritetet kompetente të Greqisë dhe Italisë, dhe zbaton të gjitha detyrimet që burojnë nga kjo direktivë, në përputhje edhe me garancitë ligjore të parashikuara në marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës, ratifikuar me ligjin nr. 102/2013.

- Duke marrë në konsideratë përputhshmërinë e sistemit të menaxhimit të sigurisë kibernetike të “TAP AG” me kërkesat e direktivës NIS2, dhe në përmbushje të angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, vlerësojmë të pranojmë kërkesën e shoqërisë “TAP AG”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së “TAP AG” për përjashtimin nga zbatimi i standardit ISO/IEC 27001, sipas “Rregullores për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturës Kritike në Sektorin e Energjisë”.

2. “TAP AG” të klasifikohet si subjekt në kuadër të zbatimit të direktivës NIS2, për sa i përket veprimtarisë në Shqipëri.

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë shoqërinë “TAP AG” dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM Nr. 148, datë 8.7.2025

MBI PEZULLIMIN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SUNPRO” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1648/13 prot., datë 2.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SunPro’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SunPro” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1648 prot., datë 30.4.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet prodhues 3 MW, me



vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, Qarku Vlorë.

Fillimi i procedurës së licencimit

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 98, datë 12.5.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.5.2025 dhe 14.5.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 12.6.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1648/3 prot., datë 21.5.2025, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, duke i kërkuar gjithashtu qëndrimin e saj mbi faktin që shoqëria nuk ka depozituar në ERE një Kontratë të nënshkruar me MIE-n, si dhe nëse kanë një qëndrim ndryshe në lidhje me këtë.

- Me shkresën nr. 1648/5 prot., datë 21.5.2025, ERE ka njoftuar edhe Autoritetin e Aviacionit Civil (AAC) për vendimin e bordit të ERE-s të sipërcituar. Në vijim të këtij njoftimi, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1648/8 prot., datë 16.6.2025, AAC ka kërkuar, që në vijim të këtij njoftimi t'i përcillet nga ERE informacion dhe dokumentacion shtesë.

- Me shkresën nr. 1648/11 prot., datë 24.6.2024, drejtuar AAC-së, për dijeni shoqërisë “SunPro” sh.p.k., ERE ka sqaruar autoritetin se duhet t'i drejtohet shoqërisë për të marrë informacionin/dokumentacionin e plotë. Në këtë shkresë janë njoftuar dhe afatet përkatëse procedurale brenda të cilave duhet të shprehet ERE për aplikimin e shoqërisë.

Kërkesa për dokumentacionin plotësues

- Me shkresën nr. 1648/4 prot., datë 21.5.2025, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës duke i kërkuar depozitimin e informacionit/ dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të munguar në këtë aplikim.

Dorëzimi dhe vlerësimi i dokumentacionit plotësues

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1648/6 prot., datë 4.6.2025, shoqëria shprehet se, duke qenë se përcaktimi në pikën 1, germa “h”, nënparagrafi “iii” të VKM-së nr. 146, datë 13.3.2025, paraqet një **të drejtë** dhe jo një

detyrim, ajo nuk ka krijuar një shoqëri të veçantë për qëllime specifike. Si e tillë, shoqëria “SunPro” sh.p.k. është mbajtësja e të drejtës për ndërtimin dhe operimin e centralit eolik. Në kuadër të këtij sqarimi, shoqëria ka depozituar një pjesë të dokumentacionit të munguar, ndërsa për pjesën e mbetur të dokumentacionit ende të paplotësuar, ka kërkuar kohë shtesë për dorëzimin e tij.

- ERE me shkresën me nr. 1648/7 prot., datë 12.6.2025, i ka kërkuar shoqërisë që, për aq sa është e mundur, të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar brenda datës 30.6.2025. Në rast se deri në këtë datë dokumentacioni nuk është ende i plotë, shoqëria të njoftojë për një afat të arsyeshëm brenda të cilit parashikon të dorëzojë pjesën e mbetur të dokumentacionit të aplikimit.

- Po ashtu, ERE i është drejtuar edhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., me shkresën nr. 1648/9 prot., datë 16.6.2025, duke i kërkuar informacion lidhur me statusin dhe fazën në të cilën ndodhet procedura për miratimin e pikës së lidhjes së centralit eolik me rrjetin elektrik, si dhe mbi afatin e pritshëm për një qëndrim përfundimtar në lidhje me kërkesën e paraqitur nga shoqëria.

- Me shkresën e saj nr. 04 prot., datë 30.6.2025, protokolluar në ERE me nr. 1648/12 prot., datë 2.7.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues në kuadër të aplikimit të saj. Gjithashtu, në të njëjtën shkresë, ajo ka paraqitur kërkesën për të plotësuar dokumentacionin e plotë dhe të përditësuar që i mungon, deri më datë 30.9.2025. Ndër dokumentet që vijnë në të mungojnë është edhe miratimi përfundimtar, respektivisht marrëveshja e nënshkruar me OST sh.a., për pikën e lidhjes së centralit eolik me rrjetin e transmetimit.

Pezullimi i afatit të vendimmarrjes

- Referuar nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, kur shqyrtimi i një çështjeje administrative varet nga një çështje tjetër ligjore e pavarur (“çështje paraprake”), për të cilën është kompetente një gjykatë ose organ tjetër, organi administrativ ka të drejtë të pezullojë procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë dhe njofton palët për pezullimin.

- Gjithashtu në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se bordi mund të vendosë,



rast pas rasti, pezullimin e vendimmarrjes pas fillimit të procedurës.

- Për sa më sipër, referuar kërkesës së shoqërisë dhe në zbatim të parashikimeve të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, të cituara më sipër, vlerësohet pezullimi i vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “SunPro” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet prodhues 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, Qarku Vlorë. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda datës 30.9.2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “SunPro” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet prodhues 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë.

2. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda datës 30.9.2025.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “SunPro” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 149, datë 8.7.2025

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN QERSHOR 2025 PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.7.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1995 prot., datë 2.7.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

Konstatoi se:

I. Aspektet ligjore dhe procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga FSHU sh.a.

Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 3834 prot., datë 1.7.2025, protokolluar në ERE me nr. 1995 prot., datë 2.7.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin qershor 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar.



II. Analiza e përlogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i mundësisë së Fundit për muajin qershor 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin qershor 2025, FSHU sh.a. ka siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh përmes blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX), duke u bazuar në profilet ditore të prokurara, çmimet ditore/orare dhe vlerat përkatëse të faturuara.

2. Përlogaritja e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes (ÇBEt)

Bazuar në të dhënat e paraqitura, FSHU sh.a. ka përlogaritur çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për muajin qershor 2025 në vlerën 10.20 lekë/kWh. Kjo vlerë është verifikuar edhe nga ERE, nëpërmjet një rillogaritjeje, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 10.20 lekë/kWh, në përputhje me përlogaritjet e paraqitura nga shoqëria.

3. Komponentët sipas Metodologjisë (neni 8, vendimi nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përlogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:

- **Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt)** për muajin qershor 2025: **10.20 lekë/kWh**;

- **Tarifa e shërbimit të transmetimit** të energjisë elektrike për periudhën 1 shkurt 2025–31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024: **0.85 lekë/kWh**;

- **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes** në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”: **1.55 lekë/kWh**;

- **Kostot administrative**: **1.06 lekë/kWh**;

- **Kurset zyrtare të këmbimit** të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro), për çdo datë respektive në harkun kohor **30.5.2025–27.6.2025**.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2025, përlogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin qershor 2025		
	Njësia	Çmimi
CBEt Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	10.20
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.31
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA	Lekë/kWh	13.97

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë **13.97 lekë/kWh për muajin qershor 2025**.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së

Fundit për muajin qershor 2025 prej 13.97 lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategoritë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtorja e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 150, datë 8.7.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OST
SHA “PËR MIRATIMIN E NJË
UDHËZUESI MBI OPERIMIN E
SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, 23 pika 1, germa “b”, 30, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016 të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE); Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.7.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1776/1 prot., datë 3.7.2025, të përgatitur nga drejtoritë teknike, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 e 2 gusht 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 2907 prot., datë 26.5.2025, protokolluar në ERE me nr. 1776 prot., datë 28.5.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e “Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485, datë 2.8.2017, mbi Udhëzuesin për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”.

- Në këtë kërkesë, OST sh.a. informon se Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë, në mbledhjen e datës 14–15 dhjetor 2022, ka miratuar vendimin nr. 2022/03/MC-EnC, përmes të cilit kjo rregullore është përfshirë në *acquis communautaire* të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si pjesë e Paketës së Energjisë së Pastër.

- Rregullorja (BE) 2017/1485, e njohur si Udhëzuesi për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, vendos një kornizë të harmonizuar për operimin e koordinuar, të sigurt dhe efikas të sistemeve elektroenergjetike në zonat sinkrone, duke përcaktuar rregulla të detajuara për OST-të dhe strukturat rajonale të koordinimit të sigurisë. Ajo synon të garantojë sigurinë operationale, stabilitetin e frekuencës dhe funksionimin në kohë reale të rrjeteve të ndërlidhura.

- Rregullorja përcakton rregulla të qarta dhe të detajuara për mënyrën se si Operatorët e Sistemeve të Transmetimit (OST-të) duhet të planifikojnë, të koordinojnë në kohë reale operimin e rrjetit dhe të shkëmbejnë të dhëna me njëri-tjetrin, me qëllim ruajtjen e stabilitetit të rrjetit, mbajtjen e cilësisë së frekuencës, menaxhimin e devijimeve dhe reagimin e përbashkët ndaj kontigjencave.

- Gjithashtu, kjo rregullore standardizon qasjen ndaj operimit të sistemit në nivel ndërkombëtar, duke e bërë të mundur sinkronizimin e proceseve operationale, krijimin e kushteve për kontrollin fuqi-frekuencë dhe përfshirjen e qendrave të koordinimit rajonal në mbështetje të OST-ve. Ajo siguron që rrjetet kombëtare të operojnë si pjesë e një sistemi të vetëm të ndërlidhur evropian, duke ruajtur integritetin dhe sigurinë e tij në çdo moment.

- Në përputhje me legjislacionin e Komunitetit të Energjisë dhe nevojën për harmonizim me rregullat e BE-së, ERE vlerëson të nevojshme nisjen e procedurës për shqyrtimin e kërkesës dhe organizimin e seancave dëgjimore dhe konsultimeve me palët e interesuara, përfshirë institucionet dhe aktorët e tregut të energjisë, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Udhëzuesit për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike” miratuar me



rregulloren e Komisionit (BE) 2017/1485, datë 2 gusht 2017.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

Nr. Regj.Them 10560
Datë regjistrimi 13.1.2025

Faza e parë e procedurës
së Falimentimit
Datë vendimi 24.7.2025

SHKURTIM VENDIMI NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e përbërë nga:

GJYQTARE: Ejona Lazellari,

me sekretare gjyqësore Kejsi Kule, në Tiranë, në datën 24.7.2025, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike, çështjen civile që i përket:

PALA KËRKUESE: “Credit 2 All” sh.p.k., shoqëri e regjistruar sipas ligjit shqiptar, përfaqësuar nga Av. Gerhard Velaj dhe Av. Silvi Tafilica, me adresë Boga & Associates, rr. “Ibrahim Rugova”, P. O. Box 8264, Tiranë.

OBJEKTI: Fillimi i procedurës së falimentimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 13, 14, 17, 29 e vijues të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së debitorit.

2. Deklarimin e hapjes të procedurës së falimentimit në orën 10:00, të datës 24.7.2025, të shoqërisë “Credit 2 All” sh.p.k., me NIPT: L716030151, me seli në adresën: Tiranë, rruga

“Medar Shtylla”, nd. 1, H. 2, ap. 59, Njësia Administrative 5, 1060, me administrator Nguyen Quoc Huoi, me adresë për efekt njoftimi: rruga “Ibrahim Rugova”, P. O. Box 8264, Tiranë.

3. Emërimin si administratore të falimentimit për shoqërinë “Credit 2 All” sh.p.k. të znj. Anida Nuri, e regjistruar në listën e administratorëve të falimentit me nr. 16 licence, me adresë: rruga “Vaso Pasha”, pallati 27, shkalla 4, apartamenti 4, Tiranë.

4. Caktimin e komitet të përkohshëm të kreditorëve të përbërë nga 5 anëtarë, përfshirë 2 kreditorët më të mëdhenj të pasiguruar dhe kreditorin më të madh të preferuar:

- Silver Case Pacific PTE. LTD;
- Individual Entrepreneur D.I;
- Piressa Holding Limited (Gelmano Consulting-cedim kredie).

5. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Credit 2 All” sh.p.k. të paraqesin pranë administratores së falimentimit pretendimet e tyre, brenda 45 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi në QKB.

6. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Credit 2 All” sh.p.k. të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruar mbi pasuritë e debitorit.

7. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, shoqërisë “Credit 2 All” sh.p.k., t’ia paguajnë dhe shlyejnë ato administratores së falimentimit znj. Anida Nuri.

8. Mbledhja për raportim e kreditorëve të shoqërisë “Credit 2 All” sh.p.k. të mbahet brenda 60 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

9. Mbledhja për verifikimin e kreditorëve të shoqërisë “Credit 2 All” sh.p.k. të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

10. Urdhërohet publikimi i shkurtimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të:

- Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- Qendrës Kombëtare të Biznesit; si dhe në
- Fletoren Zyrtare.

11. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Credit 2 All” sh.p.k. t’i njoftohet administratores së falimentimit, znj. Anida Nuri.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Credit 2 All” sh.p.k. t’i njoftohet debitorit.



13. Në zbatim të nenit 29, paragrafi 4, administratori ngarkohet me dërgimin e një kopjeje të përmbledhur të vendimit secilit prej kreditorëve të njohur të debitorit, pavarësisht nga fakti që kreditorët dhe çdo palë tjetër e interesuar konsiderohen të njoftuar si pasojë e shpalljes publike.

14. Një kopje e shkurtimit të vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Credit 2 All” sh.p.k. t’i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim njoftimin e të gjitha drejtorive vendore të ASHK-së dhe kryerjen e veprimeve, në përputhje me kriteret e ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

15. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Credit 2 All” sh.p.k. t’i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

16. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Credit 2 All” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

17. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Credit 2 All” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

18. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Credit 2 All” sh.p.k. t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Shqiptar.

19. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Credit 2 All” sh.p.k. t’i dërgohet Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit, pranë Ministrisë së Drejtësisë.

20. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Credit 2 All” sh.p.k. t’i dërgohet Dhomës Kombëtare të Noterëve.

21. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës kërkuese.

22. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

23. Ky vendim është menjëherë i ekzekutueshëm dhe ankimi ndaj tij nuk pezullon zbatimin e tij.

24. U shpall në Tiranë, sot, më datë 24.7.2025.

KËRKESË

Shtetasi Shërbim Dalla kërkon, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpalljen të zhdukur të vëllait të tij, shtetasit Përparim Dalla, me atësi Abdul dhe amësi Sadife, i datëlindjes 15.8.1946, lindur në Pashaliman, Sarandë.

KËRKUES
Shërbim Dalla

GJYQTARE
Ejona Lazellari

SEKRETARE
Kejsi Kule

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 368 lekë

